

STAR
PROJECT

Consolidation of Territorial and Administrative Reform



Institute for Democracy and Mediation
nstituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim



METODOLOGJIA E VLERËSIMIT TË RISKUT TË INTEGRITETIT PËR NJËSITË E VETËQEVERISJES VENDORE

Shtator 2019



Funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossensch
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



Empowered lives.
Resilient nations.

Ky dokument është hartuar në kuadër të aktivitetit “Forcimi i etikës dhe integritetit në Qeverisjen Vendore” në kuadër të projektit STAR II – Konsolidimi i Reformës Territoriale dhe Administrative, i zbatuar nga UNDP . Opinionet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të Grupit të Punës dhe Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e donatorit.



Funded by
the European Union



AGENZIA ITALIANA
PER LA COOPERAZIONE
ALLO SVILUPPO



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E BRENDSHME



Schweizerische Eidgenossensch
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE



Empowered lives.
Resilient nations.

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE	5
I. INTEGRITETI NË QEVERISJEN VENDORE.....	7
1.1 Qëllimi i Vlerësimit të Riskut të Integritetit të NJVV-ve	9
1.2 Parimet e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për NJVV-të	10
1.3 Qasjet e Vlerësimit të Riskut të Integritetit.....	11
II. KUADRI TEORIK I METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT TË RISKUT TË INTEGRITETIT	13
2.1 Koncepte të përgjithshme	13
2.2 Procesi i vlerësimit të riskut të integritetit	14
2.2.1 Vendosja e objektivave në procesin e VRI	15
2.2.2 Identifikimi i risqeve.....	15
2.2.3 Vlerësimi i risqeve	17
2.2.4 Trajtimi i risqeve.....	19
2.2.5 Plani i veprimit të menaxhimit të risqeve.....	20
2.2.6 Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit-Plani i Integritetit.....	20
2.3 Metodatat e vlerësimit	21
III. RISQET E INTEGRITETIT NË BASHKI	23
3.1 Fusha e menaxhimit financiar (buxheti, të ardhurat dhe shpenzimet)	23
3.2 Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore	25
3.3 Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit.	27
3.4 Fusha e shërbimeve publike.....	30
3.5 Fusha e administrimit dhe menaxhimi i pronave	32
3.6 Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimi të territorit.....	33

3.7 Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronik.....	34
IV. PROCESI I VLERËSIMIT TË RISKUT TË INTEGRITETIT NË BASHKI	36
Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore	36
Faza 2: Identifikimi dhe analiza e riskut	37
Faza 3: Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe trajtimi i tyre	38
Faza 4: Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut dhe Regjistri i Riskut.....	38
Faza 5: Monitorimi dhe raportimi.....	38
V. MODELI I PLANIT TË INTEGRITETIT PËR BASHKINË	42
5.1 Informacion bazë për institucionin dhe personat përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e Planit të Integritetit.....	44
5.2 Model urdhri për hartimin e një plani integriteti për Bashkinë	45
5.3 Modeli i njoftimit për hartimin e Planit të Integritetit.....	47
5.4 Programi i punës i Grupit të Punës për planifikimin e integritetit	48
5.5.Regjistri i riskut	50
5.6 Plani për menaxhimin e riskut të integritetit	51
5.7 Modeli i Vendimit për Miratimin dhe Zbatimin e Planit të Integritetit	52
SHTOJCA 1. PYETËSORI PËR BASHKITË	53
BIBLIOGRAFIA	62

HYRJE

Ky dokument prezanton Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (MVRI) dhe synon të kontribuojë në forcimin dhe zhvillimin e integritetit të qeverisjes vendore. Vlerësimi i riskut të integritetit përbën një pjesë tejet të rëndësishme për arritjen e vizionit dhe misionit të bashkisë dhe strukturave në varësi të saj.

MVRI është një dokument që hartohet për herë të parë në vendin tonë dhe i referohet përgjegjësive dhe objektivave të vendosura në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit (SNKK) 2015-2020¹ dhe masave të Planit përkatës të Veprimit 2018-2020. Strategjia dhe Plani i saj i Veprimit 2018-2020 parashikon objektiva konkrete në funksion të planifikimit të integritetit me objektivin e përgjithshëm për të pasur një kulturë të vlerësimit të integritetit në nivel njësie të vetëqeverisjes vendore (NJVV).

Objektivi A. 9. Forcimi i integritetit të nëpunësve publikë, i parashikuar në Planin e Veprimit 2018 -2020, sqaron se plani i integritetit ofron kuadrin konceptual për politikatat dhe masat për parandalimin e shkeljeve të integritetit të zyrtarëve publikë dhe për monitorimin e efekteve të masave të zbatuara në një institucion publik, përfshirë këtu edhe ndershmërinë dhe integritetin e individëve, të cilët punësohen në sektorin publik si parakusht për parandalimin e korrupsionit. Sipas dokumentit të Strategjisë (2015-2020), është vendimtare që në disa sektorë të qeverisjes, të cilët janë të prirur për korrupsion (p.sh. polici, prokurime, tatime, gjyqësor, etj.), sektorët e personelit të miratojnë dhe zbatojnë metodologji për të testuar paraprakisht integritetin e kandidatëve për këto vende pune dhe në vijimësi integritetin e punonjësve. Nga ana tjetër, në strategji evidentohet edhe çështja e mungesës sistemike të politikës anti-korrupsion në nivel vendor, e cila do të ishte e aplikueshme për të gjithë NJVV-të, por që do të merrte në konsideratë nevojat dhe cilësitë e veçanta të tyre.

Objektivi A.11. Miratimi i politikave kundër korrupsionit në nivelin e qeverisjes vendore për bashkitë janë një domosdoshmëri dhe një objektiv specifik i Strategjisë dhe i Planit të saj të Veprimit, në të cilin parashikohet promovimi i planeve vendore të integritetit në nivel bashkiak, si një mundësi që qytetarët të njohin përpjekjet anti-korrupsion dhe të kontribuojnë në mënyrë aktive për to. Plani i Veprimit (2018-2020), i miratuar në maj të vitit 2018, parashikon si masë në kuadër të këtyre objektivave hartimin dhe miratimin e planit të integritetit, një

¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.247 datë 20.03.2015 "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020"

mekanizëm anti-korrupsion, për çdo institucion publik në vend. Plani i integriteti ofron kuadrin konceptual për politikat dhe masat për parandalimin e shkeljeve të integritetit të zyrtarëve publikë dhe për monitorimin e efekteve të masave të zbatuara në një institucion publik.²

Me qëllimin për të ndihmuar NJVV-të në përpjekjet e tyre për të miratuar politika anti-korrupsion më nivel vendor MVRI synon t'u shërbejë bashkive në hartimin e planeve vendore të integritetit. Metodologjia mbështetet kryesisht në analizën e kuadrit kombëtar ligjor për vetëqeverisjen vendore, veçanërisht në fushat e funksionit që mbartin rreziqe të cenimit të integritetit.

Zbatimi i kësaj metodologjie në nivel të qeverisjes vendore do të bëjë të mundur krijimin e një sistemi efektiv për menaxhimin e integritetit në institucion si një standard të lartë menaxhimi që i përshtatet një administrate vendore moderne. Kjo vjen në linjë edhe me rekomandimet e Komisionit Evropian (2018) për Shqipërinë në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Evropian.³ Një nga rekomandimet e dhëna është zbatimi i dokumentit të Strategjisë Kundër Korrupsionit, duke iu referuar konkretisht mungesës së një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit në institucionet publike në vend.

Metodologjia ka një qasje gjithëpërfshirëse për të identifikuar, analizuar, vlerësuar, trajtuar, monitoruar dhe komunikuar rreziqet kryesore të integritetit që shoqërojnë përgjegjësitë e njësive të vetëqeverisjes vendore. Në këtë qasje, ajo siguron që vlerësimi i riskut të integritetit, si pjesë e sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit, të jetë në themel të kulturës organizative të bashkisë, i integruar në planet dhe veprimtaritë e përditshme të punës të saj.

² Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 241, datë 20.4.2018 "Për miratimin e Planit të Veprimit 2018-2020".

³ http://parlament.al/web/Keshilli_Kombetar_i_integritetit_Europian_20627_1.php

I. INTEGRITETI NË QEVERISJEN VENDORE

Integriteti është koncept i qëndrueshmërisë së veprimeve, vlerave, metodave, masave, parimeve dhe rezultateve. Ai shpesh përkufizohet si e kundërta e korrupsionit, p.sh. sjellja e bazuar në mënyrë strikte në një kod moral, që reflekton ndershmëri, transparencë dhe harmoni të plotë me atë çka një person mendon, thotë dhe kryen.⁴

Studimet dhe praktikat më të fundit ndërkombëtare sugjerojnë se integriteti nuk është një karakteristikë personale, por mënyra për të përshkruar veprimet apo zgjedhjet e bëra nga një person, pra si “koncept veprimi”, i cili, i parë në kontekstin e sektorit publik, kuptohet si përgjegjshmëri e qeverisjes.⁵

Integriteti i institucioneve dhe zyrtarëve publike është shtylla e një shoqërie demokratike. Ai është një gur themeli i qeverisjes së mirë, një parakusht për ligjshmërinë e veprimeve të qeverisë dhe ka një rëndësi të veçantë në kontekstin e luftës kundër korrupsionit.

Në përpjekje të forcimit të integritetit të sektorit publik, për qeverisjen qendrore, vendore por dhe për sektorin privat, i cili kryen shërbime publike, dhe në mungesë të një kuadri ligjor të konsoliduar për integritetin, Shqipëria ka miratuar një kuadër të mirë sektorial, i cili përfshin ligje dhe akte nënligjore mbi:

- a. instrumentet e integritetit si: për etikën, integritetin, konfliktin e interesave, deklarin e pasurisë, denoncimin e korrupsionit, për integritetin në fushën e funksioneve administrative, etj.;
- b. instrumentet mbështetës të menaxhimit të shëndoshë të integritetit si: administrimin e shërbimeve publike, burimeve financiare, burimeve njerëzore, prokurimeve publike, etj.

Ky legjislacion përcakton: parimet e përgjithshme të etikës dhe integritetit për administratën publike; standardet që duhet të përmbushin zyrtarët e administratës publike në ushtrimin e detyrave të tyre; standardet për një mirëqeverisje të pushtetit vendor duke u fokusuar kryesisht tek parimi i transparencës, konsultimi publik dhe pjesëmarrja në vendimmarrje; instrumentet kryesorë të lidhura me

⁴ Pallia, H. (2014) Integrity and Integrity management. Gjetet në adresën: [http://corruptionprevention.gov.hu/download/8/f2/90000/Integrity%20and%20integrity%20management%20\(Katalin%20Pallai\).pdf](http://corruptionprevention.gov.hu/download/8/f2/90000/Integrity%20and%20integrity%20management%20(Katalin%20Pallai).pdf).

⁵ Topal, J. (2016) Introducing the Dutch Approach to Governmental Integrity. Gjetet në adresën: http://integrityobservers.eu/UserDocslmages/Dutch_Approach.pdf.

etikën publike dhe integritetin si: konflikti i interesit, dhuratat dhe favoret, punësime dhe kufizimet pas punësimit; denoncimi i korrupsionit në sektorin publik dhe atë privat, etj.

Risku i integritetit është një problem që ekziston në të gjitha nivelet e qeverisjes. Në qeverisjen vendore, megjithëse procesi i decentralizimit (transferimi i pushteteve dhe përgjegjësi nga qeverisja qendrore në atë vendore) synon të shërbejë në forcimin e llogaridhënies duke e sjellë qeverinë më afër qytetarëve, decentralizimi i shërbimeve publike mund të decentralizojë shfaqjen apo mundësinë e shfaqjes së riskut të integritetit, por jo ta zvogëlojë apo eliminojë plotësisht atë. Kontaktet ndërmjet zyrtarëve të qeverisjes vendore dhe publikut janë më të shpeshta në qeverisjen vendore, duke rritur kështu dhe mundësitë për shfaqjen e risqeve të integritetit, të tilla si sjellje apo veprime korruptive nga ana e zyrtarëve të bashkisë, raste të shfaqjes së konfliktit të interesit si pjesëmarrës në vendimmarrje për çështje të caktuara, mashtrim, nxjerrje e një informacioni konfidencial apo privat, diskriminimi, shpërdorimi i detyrës etj. Në këtë kontekst, për shkak të kontakteve të shpeshta mes zyrtarëve vendorë dhe qytetarëve, nevoja për të forcuar sisteme të menaxhimit të integritetit është e madhe.

Bashkia është një punëdhënës i rëndësishëm vendor, disponon një buxhet të konsiderueshëm dhe, si rrjedhojë, është e ekspozuar ndaj risqeve të ndryshme dhe të mëdha të korrupsionit. Zyrtarët vendorë gëzojnë liri veprimi dhe monopolin mbi vendimmarrje të ndryshme në lidhje me shërbimet publike, të tilla si arsimi, zhvillimi ekonomik, shëndetësia, furnizimi me ujë të pijshëm, etj. Bashkëpunimet ndërmjet sektorit publik dhe atij privat, ndikimi i partive politike apo grupeve të interesit të qeverisja vendore krijojnë një sërë mundësish për shfaqjen e korrupsionit. Mungesa e rregullave të brendshme në nivel institucioni të bashkisë, kompleksiteti, inkoherenca apo paqartësia e tyre në rastet kur ato janë të miratuara dhe procedurat e brendshme administrative të shoqëruara me formalitete të shumta burokratike përbëjnë rreziqe për zbatimin e ligjshmërisë dhe krijojnë mundësi për shkeljen e integritetit të bashkisë. Nga ana tjetër, kjo gjë cenon efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve publike në nivel vendor. Në këtë kuadër, ngritja e një sistemi funksional të menaxhimit të integritetit në nivel bashkie do të rriste rezistencën organizative ndaj korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të integritetit, do të përmirësonte performancën e integritetit të bashkisë, por edhe efikasitetin, transparencën dhe cilësinë e shërbimeve publike.

1.1 Qëllimi i Vlerësimit të Riskut të Integritetit të NJVV-ve

Vlerësimi i riskut të integritetit (VRI) për NJVV-të është një instrument që rrjedh nga objektivat e parashikuara në SNKK dhe masat përkatëse në Planin e Veprimit 2018-2020 për zhvillimin dhe miratimin e politikave anti-korrupsion në nivel vendor. Ai është një mekanizëm parandalues anti-korrupsion instrument për futjen e mirëqeverisjes dhe mirë-menaxhimit në veprimtarinë e NJVV, duke i shërbyer nevojave dhe interesave të komunitetit vendor.

Koncepti i VRI i propozuar në këtë dokument bazohet në identifikimin e rreziqeve ligjore, institucionale, organizative dhe praktike të integritetit. VRI është komponent përbërës i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit në bashki. Ky proces përfshin identifikimin e risqeve organizative ndaj shkeljeve të integritetit dhe vlerësimin e tyre. Vlerësimi i riskut vijon me parashikimin e masave për përmbushjen e objektivave të integritetit, forcimin e sundimit të ligjit dhe vlerave dhe standardeve profesionale. Në përfundim të procesit të vlerësimit të riskut të integritetit hartohet *plani i integritetit*, një dokument strategjik dhe operacional që mbështetet në rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut në bashki.

Vlerësimi i Riskut të Integritetit në bashki ka për qëllim:

- të rrisë mundësinë për përmbushjen e objektivave organizative, të mbështetur në menaxhimin proaktiv të riskut të integritetit.
- të vendosë në vëmendje prioritetet bazuar në rezultatet e procesit të vlerësimit të riskut të integritetit, duke koordinuar shpërndarjen në mënyrë efikase të burimeve të që ka bashkia në dispozicion;
- të sigurojë që kërkesat ligjore dhe procedurale zbatohen me përpikëri nga zyrtarët vendorë (autoritetet dhe administrata);
- të forcojë kapacitetet organizative në çështje të integritetit, përmes ndërgjegjësimit në të gjitha nivelet e drejtimit dhe administratës së bashkisë për zbatimin dhe monitorimin e planeve të integritetit;
- të rrisë besimin e publikut në performancën e integritetit të bashkisë.

Qëllimi i këtij dokumenti është hartimi, miratimi, zbatimi efektiv, monitorimi periodik dhe vlerësimi i rezultateve të planit të integritetit, për t'i bërë NJVV-të më të qëndrueshme dhe të ndjeshme ndaj risqeve të integritetit në kontekstin e ushtrimit të përgjegjësive dhe kompetencave.

1.2 Parimet e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për NJVV-të

Metodologjia e VRI-së është e mbështetur në disa parime kryesore që shoqërojnë përgjegjësitë e qeverisjes vendore, zbatimi i të cilave ndikon në parandalimin e shkeljeve që cenojnë integritetin e bashkisë. Në këto parime përfshihen:

- Minimizimi i pushtetit diskrecional të tepërt dhe të panevojshëm i autoriteteve ekzekutive dhe përfaqësuese të bashkisë, administratës apo organeve/strukturave në marrjen e një vendimi, dhe/ose qartësi në përcaktimin e kriterëve, procedurave dhe standardeve për procesin e vendimmarrjes.
- Rritja e transparencës në punën e bashkisë minimizon risqet apo mundësitë për risqe që dëmtojnë integritetin e organizatës së bashkisë.
- Rritja e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve dhe administratës vendore si garanci për zbatimin e ligjshmërisë në nivel vendor.
- Forcimi i mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm të bashkisë. Në parim, çdo veprim i autoritetit publik duhet të jetë objekt kontrolli për të ruajtur sistemin e “kontrollit dhe ekuilibrit të pushtetit” dhe parimin e ndarjes së pushteteve.
- Thjeshtimi dhe riorganizimi i procedurave të zbatuara nga autoritetet, organet apo administrata vendore, të cilat nuk përmbushin qëllimin për të cilin janë miratuar dhe krijojnë mundësi për risqe integriteti.⁶

Pavarësisht se metodologjitë e vlerësimit të riskut të integritetit janë të ndryshme në vende të ndryshme, parimet e përgjithshme mbeten të njëjta, në përputhje me standardet ndërkombëtare të menaxhimit të riskut.⁷ Karakteristikat kryesore të procesit të vlerësimit të riskut janë të mëposhtmet. Vlerësimi i Riskut të Integritetit:

- krijon dhe mbron vlerat etike të bashkisë;
- kërkon mbështetje të udhëheqjes së bashkisë (mbështetje e plotë dhe përkushtimin e nivelit të lartë drejtues dhe përfaqësues të bashkisë);
- është pjesë e qeverisjes së institucionit, i integruar me proceset e veprimtarisë së bashkisë;
- është pjesë e vendimmarrjes;

⁶ Mojsilović, M. (2017) “Model of Anti-corruption plan with Guidelines for Adoption, Implementation and Monitoring”. Anti-Corruption Agency, Republic of Serbia, Belgrade

⁷ ISO 31000: 2018 (en) Risk management-Guidelines, i cili ka zëvendësuar ISO 31000: 2009 Risk management- Principles and guidelines, BS 10500 Specification for an anti-bribery management system, BS EN ISO 9001:2008, Quality management systems – Requirements, Federation of European Risk Management Associations (FERMA) Risk Management Standard, e disponueshme në <http://www.ferma.eu/app/uploads/2011/11/a-risk-management-standard-englishversion.pdf>, Association of Insurance and Risk Managers (AIRMIC), Public sector risk management association (Alarm) and Institute of Risk Management (IRM)- A Guide to ISO 31000, e disponueshme më <http://www.ferma.eu/app/uploads/2011/10/a-structured-approach-to-erm.pdf>, Good Practice Guidance on Internal Controls, Ethics, and Compliance. Paris: OECD, A Guide for Anticorruption Risk Assessment, UN Global Compact, 2013, Gjetet në adresën: <https://www.unglobalcompact.org/resources/411>

- është sistematik, i strukturuar dhe periodik (në të cilin për secilin risk shqyrtohen si mundësia ashtu edhe pasoja);
- duhet të jetë i dokumentuar dhe i bazuar në informacionin më të saktë të mundshëm (regjistrimi i vlerësimit të riskut lehtëson monitorimin dhe identifikimin e prioriteteve të riskut);
- merr në konsideratë faktorët njerëzorë dhe kulturorë;
- është transparent dhe përfshirës;
- është dinamik, ndërveprues dhe reagues ndaj ndryshimeve;
- bën të mundur përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë së bashkisë, forcon integritetin dhe rrit besueshmërinë e qytetarëve.

1.3 Qasjet e Vlerësimit të Riskut të Integritetit

Metodologjia e propozuar e VRI për NJVV-të mbështetet në analizën e kuadrit ligjor për vetëqeverisjen vendore dhe të instrumenteve mbështetëse të integritetit. Një referencë e mirë ka qenë instrumenti praktik për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Programi i Zhvillimit i Kombeve të Bashkuara (PNUD/UNDP) “Udhëzuesit për qeverisje vendore pa korrupsion”.⁸ Strategjia e Menaxhimit të Riskut e Kontrollit të Lartë të Shtetit ka qenë orientuese për kuptueshmërinë e ciklit të menaxhimit të riskut të integritetit përfshirë procesin e vlerësimit të riskut, që është objekt i këtij dokumenti.⁹ Në hartimin e këtij dokumenti janë konsultuar praktika të mira ndërkombëtare në sistemet të menaxhimit të integritetit në sektorin publik, të tilla si ajo e Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Bosnje Hercegovinës, Serbisë, Kroacisë, etj.

Vlerësimi i riskut të integritetit në bashki ka një qasje gjithëpërfshirëse institucionale, pasi bashkia nëpërmjet një procesi vetë-vlerësimi synon të trajtojë risqet e shkeljes së integritetit në të gjitha veprimtaritë e saj me qëllim forcimin e rezistencës institucionale ndaj korrupsionit, duke parandaluar apo zvogëluar risqet e integritetit si dhe mundësinë e ndodhjes apo ndikimit të tyre. Kryetari i Bashkisë ngre një grup pune për realizimin e vlerësimit të riskut në bashki. Grupi i punës kryesohet nga një koordinator, nën drejtimin e të cilit grupi i punës merr detyrat për procesin e vlerësimit të riskut të integritetit në bashki.

Ky proces i vlerësimit të riskut të integritetit ka një qasje gjithëpërfshirëse. Të gjitha strukturat e brendshme të bashkisë angazhohen të mbështesin grupin e

⁸ Monkova. M. (2018) “Guide to Corruption-Free Local Government”: UNDP. Gjetet në adresën: <http://localizingthesdgs.org/library/486/Guide-To-Corruption-Free-Local-Government.pdf>

⁹ Urdhri Nr. 41, datë 30.03.2015, i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Kontrollin e Lartë të Shtetit”.

punës në identifikimin e risqeve, vlerësimin dhe rishikimin e masave ekzistuese për trajtimin e tyre. Për këtë qëllim, përgatitet edhe një pyetësor vetëvlerësimi, i cili mbulon të gjitha fushat e funksionit të bashkisë që paraqesin risqe të shkeljes së integritetit. Rezultatet e vetëvlerësimit bëhen publike për transparencë si edhe për të siguruar bazën e nevojshme për përmirësimin e metodave dhe mjeteve si dhe të vetë procesit të vlerësimit.

Monitorimi dhe raportimi i planit të integritetit është një tjetër qasje e menaxhimit të riskut në bashki. Monitorimi është periodik (çdo vit) dhe përfshin kryerjen e aktiviteteve nga ana e punonjësve dhe drejtuesve të bashkisë, për zbatimin e masave të miratuara për trajtimin e risqeve, në përputhje me përgjegjësitë që ata kanë. Ndërsa raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të veprimit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës, i caktuar nga kryetari i bashkisë, i cili është përgjegjës për progresin e zbatimit. Frekuenca minimale e raportimit është brenda periudhës tre mujore.

II. KUADRI TEORIK I METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT TË RISKUT TË INTEGRITETIT

2.1 Koncepte të përgjithshme

“**Integriteti vendor**” është prirja e autoriteteve vendore, administratës dhe organeve të veçanta për t’i rezistuar tundimit për të abuzuar me të drejtat dhe privilegjet që ofron ushtrimi i përgjegjësisë të tyre. Integriteti mund të jetë individual dhe organizativ. Integriteti individual është forca morale e lidhjes së sjelljes me vlerat etike dhe rregullat. Ndërsa integriteti i organizatës ekziston kur institucioni i bashkisë vepron në përputhje me listën e vlerave etike të përcaktuara qartë dhe të rregullave të miratuara.

“**Risk**” është mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje të caktuar, e cila do të ndikonte negativisht në arritjen e objektivave dhe integritetin e institucionit. Mundësia përkufizohet si gjasat që një ngjarje të ndodhë dhe të ketë ndikim në arritjen e objektivave.¹⁰

“**Risku i integritetit**” përkufizohet si efekt i pasigurisë për objektivat organizative i shkaktuar nga korrupsioni dhe shkeljet e integritetit (e përshtatur nga udhëzuesi ISO 73:2009, përkufizimi 1.1).¹¹

“**Faktori i riskut**” nënkupton çdo atribut, karakteristikë apo ekspozim ndaj riskut, të individit, institucionit apo procesit që rrit mundësinë e ndodhjes së një sjelljeje korruptive, cenimi të integritetit, sjellje jo-etike apo çdo lloj sjellje tjetër e cila mund të ketë efekt negativ në objektivat, qëllimet e institucionit (p.sh. ushtrimi i kompetencave apo proceset vendimmarrëse).¹²

“**Vlerësim i riskut**” sipas përkufizimit të dhënë në dokumentin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut¹³ (2015) është procesi i vlerësimit të riskut lidhur me ndikimin që sjell nëse një risk ndodh apo mundësisë që risku të ndodhë. Pra,

¹⁰ Ligji nr. 10 296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

¹¹ Monkova, M. (2015) “Udhëzues për planifikimin e integritetit dhe menaxhimin e integriteti, Kosovë: UNDP, f. 9.

¹² Selinsek, Liljana (2015) “Corruption Risk Assessment in Public Institutions in South East Europe Comparative Study and Methodology”, Regional Corporation Council, f. 18 (e disponueshme: http://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/10/CRA_in_public_ins_in_SEE-WEB_final.pdf).

¹³ Urdhri Nr. 41, datë 30.03.2015, i Kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Kontrollin e Lartë të Shtetit”.

risqet analizohen duke shqyrtuar mundësitë dhe ndikimin, si një bazë për të vendosur se si do të menaxhohen në vazhdimësi.¹⁴

2.2 Procesi i vlerësimit të riskut të integritetit

Njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre, përballen me risqe korrupsioni që mund të kenë pasoja negative në përmbushjen e objektivave të synuara. Prandaj, VRI është procesi përmes së cilit bashkitë në mënyrë metodike dhe periodike trajtojnë risqet e integritetit në të gjitha veprimtaritë e bashkisë me qëllim forcimin e rezistencës institucionale ndaj korrupsionit si dhe duke ndikuar në parandalimin ose zvogëlimin e risqeve.

VRI është komponent i sistemit të menaxhimit të riskut të integritetit në bashki. Menaxhimi i riskut të integritetit në bashki përfshin 6 komponentë të cilët janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin:

1. Vendosja e Objektivave;
2. Identifikimi i risqeve;
3. Vlerësimi i risqeve;
4. Trajtimi i risqeve;
5. Plani i veprimit për menaxhimin e riskut dhe regjistri i riskut;
6. Monitorimi dhe raportimi.

¹⁴ Sipas përkufizimeve të dhëna nga Strategjia e Menaxhimit të Riskut të KLSH (2015), “risku i qenësishëm” (inherent) është ekspozimi që del nga një risk specifik përpara se të ndërmerret ndonjë veprim për menaxhimin e tij (para ndërmarrjes së veprimeve për identifikimin dhe eliminimin e tij). Ndërsa “risku i mbetur” (residual) është ekspozimi ndaj një risku specifik pas ndërmarrjes së veprimeve për identifikimin dhe eliminimin tij, si dhe prezumimit se ky veprim i ndërmarrë ka qenë efektiv.

Figura 2: Procesi i Vlerësimit të Riskut



2.2.1 Vendosja e objektivave në procesin e VRI

Procesi i VRI është pjesë integrale e planifikimit strategjik me qëllim identifikimin dhe vlerësimin e risqeve të integritetit që lidhen me zbatimin e objektivave të parashikuara në planin strategjik të bashkisë. Objektivat janë strategjike,¹⁵ programore dhe operacionale¹⁶ dhe përcaktohen sipas fushave të funksionit të bashkisë.

2.2.2 Identifikimi i risqeve

Pas vendosjes së objektivave, procesi vijon me identifikimin e risqeve të integritetit që përfshin gjetjen, njohjen dhe përshkrimin e risqeve, që mund të ndikojnë në arritjen e objektivave të vendosura. Identifikimi i risqeve i referohet përvojës së kaluar të bashkisë që gjendet në raporte e ndryshme të veprimtarisë së saj, si edhe të ardhmes që lidhet më ndryshimet e pritshme politike, ekonomike, sociale, etj. Risqet identifikohen përmes dy qasjeve:

- nga lartë-poshtë, ku konsiderohen risqet që lidhen me objektivat në nivelin më të lartë hierarkik, objektivat e përgjithshme dhe specifike, (kryetarët/drejtorët dhe këshilli bashkiak);
- nga poshtë –lartë, ku përfshihen të gjitha sektorët e bashkisë të cilat bëjnë shqyrtimin e aktiviteteve dhe proceseve të tyre të punës për të vlerësuar risqet.

¹⁵ Objektivat afatmesëm dhe strategjike të bashkisë zakonisht përfshijnë periudhën 3.5 ose më shumë vite.

¹⁶ Objektivat operacionale janë objektivat afatshkurtra të përcaktuara në planet e punës vjetore të bashkisë.

Këto dy qasje mund të ndërthuren mes tyre duke lehtësuar përcaktimin e risqeve. **Risqet e identifikuar mund të jenë risqe të jashtme ose risqe të brendshme.** **Risqet e jashtme** janë risqe që lidhen me mjedisin jashtë bashkisë, të tilla si: risqe të nivelit makro (ekonomik, forcë madhore); vendimet politike, ambienti social dhe teknologjik, partnerët e jashtëm (agjencitë, media, biznesi etj.). **Risqet e brendshme** rrjedhin nga veprimtaria e bashkisë dhe përfshijnë:

1. risqe të lidhura me aspektet e ligjshmërisë dhe mbikëqyrjes: qartësi, qëndrueshmëri dhe saktësi në rregullore e bashkisë dhe rregullat/procedura e miratuara;
2. risqe që lidhen më burime njerëzore dhe institucionin: burime njerëzore; etika dhe sjellja në institucion; organizimi i brendshëm etj.
3. risqe që lidhen me informimin dhe komunikimin: metodat, format dhe kanalet e komunikimit; informacioni i vënë në dispozicion i cilësisë së lartë dhe në kohë;
4. risqe që lidhen me planifikimin, proceset dhe operacionet e bashkisë të tilla si: procese operationale; procese financiare; sistemi TIK dhe sistem të tjera mbështetëse.

Në këtë etapë përfshihet edhe identifikimi i faktorëve të risqeve si dhe i ndikimit që këta faktorë mund të kenë në integritetin e bashkisë.

Këshilli i Bashkëpunimi Rajonal (2015),¹⁷ faktorët e riskut i ka klasifikuar në 4 grupe, përkatësisht: faktorët të jashtëm; të brendshëm, individual dhe të lidhur me procese pune, të paraqitura në tabelën 1 më poshtë.

Tabela 1. Burimet e riskut

LLOJET E RISKUT	SHEMBUJT E RISKUT
Faktorë risku të jashtëm (faktorë jashtë kontrollit të bashkisë)	- paqartësi, mangësi dhe inkoherencë ligjore të legjislacionit në fuqi mbi etikën, integritetin konfliktin e interesi etj. - paqartësi në kompetencat e atribuara për titullarët;
Faktorë risku të brendshëm (të cilët janë brenda sistemit të kontrollit të bashkisë që rrjedhin nga veprimet apo mosveprimet e saj)	- pasaktësi apo mangësi në aktet e brendshme rregullatore; - masa të dobëta menaxheriale dhe administrative
Faktorë risku individualë (faktorë të cilët mund të motivojnë zyrtarët për kryerjen e sjelljes jo etike, korruptive që çënojnë integritetin)	- mungesa e njohurive; - mungesë integriteti; - mungesa e aftësive praktike; - presione në ambientin e punës;

¹⁷ Selinsek, L. (2015) "Corruption Risk Assessment in Public Institutions in South East Europe Comparative Study and Methodology", Regional Corporation Council , 2015; fq 19-20 (gjetet në këtë adresë: http://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/10/CRA_in_public_ins_in_SEE-WEB_final.pdf)

	<ul style="list-style-type: none"> - supervizim i ulët mbi detyra të caktuara; - marrëdhënie jo e duhur me punonjësit;
Faktorë risku të proceseve të punës (faktorët që krijohen nga procedurat dhe proceset e punës në bashki)	<ul style="list-style-type: none"> - Punonjësit zotërojnë një autonomi më të madhe në vendimmarrje; - vendimmarrje jo transparente; - organizim i dobët i proceseve të punës; - procese të paqarta pune; - mungesë përgjegjësie; - mungesë e kontrollit vertikal ose horizontal në proceset e punës

Burimi: Corruption Risk Assessment in Public Institutions in South East Europe Comparative Study and Methodology (2015)

Në tabelën nr. 2 janë paraqitur disa lloje të ndikimit që mund të sjellë në integritetin e bashkisë ndodhja apo mundësia e ndodhjes së disa risqeve të identifikuar.

Tabela 2. Ndikimi i mundësisë së ndodhjes së riskut në integritetin e bashkisë

NDIKIMI I RISKUT	NGJARJET E MUNDSHME (SHEMBUJ)
Strategjik	Mos-arritja ose mos-përmbyshja e objektivave të bashkisë;
Operacional	Mungesë energjie elektrike ose uji; prishja e pajisjeve; mungesë furnizimi dhe materialesh; pamundësi për të hyrë në ambientet e punës; mungesë stafi.
Reputacioni	Shërbime të varfra; shërbim i keq ndaj qytetarëve; publicitet negativ në media.
Financiar	Vjedhje ose keqpërdorim i fondeve, mungesë likuiditeti për të kryer operacionet, kufizime buxheti.
Përputhshmëria	Mospërputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, shkelje të marrëdhënieve kontraktuale.

2.2.3 Vlerësimi i risqeve

Risqet e identifikuar në etapën e mësipërme do të vlerësohen në lidhje me:

- mundësinë e ndodhjes së një ngjarjeje të padëshiruar kur nuk ka aktivitete kontrolli ose kur ato janë të pamjaftueshme për të parandaluar apo ulur riskun; si edhe
- pasojën që një ngjarje e padëshiruar do të kishte në bashki nëse do të ndodhte. Pasoja mund të jetë një lloj dëmi që shkaktohet ose mundësi që nuk shfrytëzohet (i cili mund të jetë sasior ose i përshkruar në terma specifik).

Mundësia e ndodhjes së riskut dhe ndikimi i tij, ndahet në tre kategori vlerësimi: i lartë/i moderuar/ i ulët.

Tabela 3. Klasifikimi i vlerësimit të mundësisë së ndodhjes së një risku dhe vlerësimi i ndikimit të shfaqjes së tij:

Vlerësimi	Rezultati	Vlerësimi i mundësisë/ probabilitetit të shfaqjes së riskut	Vlerësimi i ndikimit/ ndikimit të shfaqjes së riskut
I ulët	1	Risku nuk u shfaq në të kaluarën ose shfaqet shumë rrallë, kështu që nuk ka gjasa që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen	Ndikimi për integritetin e institucionit është i parëndësishëm
I moderuar / i mesëm	2	Risku është shfaqur në disa raste në të kaluarën, kështu që probabiliteti i ndodhjes në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen është i moderuar	Ndikimi është i rëndësishëm për integritetin e institucionit
I lartë	3	Risku është shfaqur shpeshherë në të kaluarën dhe ekziston një gjasë e madhe që kjo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen	Ndikimi është shumë i rëndësishëm për integritetin e institucionit

Vlerësimi i riskut nënkupton renditjen e risqeve të integritetit duke filluar nga risqet më prioritare që paraqesin ndikim thelbësor në integritetin e bashkisë dhe që mund të rrezikojnë efikasitetin dhe reputacionin e bashkisë deri te risqet e ulëta, të cilat nuk mund të kenë nevojë për masa por mjafton të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme.

Renditja e risqeve bëhet sipas rëndësisë dhe përfshin vlerësimin midis mundësisë së ndodhjes apo shfaqjes së një risku dhe ndikimit të tij në integritetin e bashkisë. Në këtë mënyrë, identifikohen risqet prioritare për bashkinë, të cilat duhet të trajtohen nga masa të menjëhershme për përmirësimin e integritetit. Rezultati i nga shumëzimi i mundësisë së ndodhjes së një risku me ndikimin që ai ka në integritetin e institucionit nëse ai ndodh/shfaqet na jep një përgjigje për intensitetin e riskut të identifikuar (1 dhe 2 e ulët, 3 dhe 4 e mesme dhe 6 dhe 9 e lartë – tabela 4). Për shembull, në një situatë ku grupi i punës vlerëson se “mungesa e fondeve për të investuar në kohë në shkolla do të shfaqet dhe përsëritet më shumë se një herë” dhe se “ndikimi është shumë i rëndësishëm për integritetin e bashkisë”, prodhimi $3 \times 3 = 9$, tregon që intensiteti i riskut është i lartë dhe masat për zvogëlimin e këtij risku janë të menjëhershme.

Tabela 4. Vlerësimi i intensitetit të riskut- Matrica e riskut

VLERËSIMI I INTENSITETIT TË RISKUT		VLERËSIMI I RISKUT		
		Risku nuk u shfaq në të kaluarën ose shfaqet shumë rrallë, kështu që nuk ka gjasa që kjo të ndodhë në të ardhmen (1)	Risku është shfaqur në një numër rastesh në të kaluarën, kështu që gjasat që kjo do të ndodhë në të ardhmen është e moderuar (2)	Risku shpesh është shfaqur në të kaluarën dhe ka gjasë të madhe që kjo të ndodhë në të ardhmen (3)
PASOJAT E SHFAQJES SË RISKUT	Ndikimi për integritetin e institucionit është i parëndësishëm (1)	1	2	3
	Ndikimi për integritetin e institucionit është i rëndësishëm (2)	2	4	6
	Ndikimi për integritetin e institucionit është shumë i rëndësishëm (3)	3	6	9

2.3.4 Trajtimi i risqeve

Renditja e risqeve sipas prioriteteve shërben si bazë për përcaktimin e masave¹⁸ për trajtimin e risqeve të identifikuara. Përcaktimi i masave prioritare bëhet në mënyrë që burimet që ka bashkia (financiare, njerëzore, infrastrukturore, etj.) të akordohen sipas nevojave. Risqet prioritare kërkojnë trajtim të menjëhershëm me masa prioritare. Për risqet e kategorizuara si të ulëta, mund të caktohet monitorimi i vazhdueshëm ose periodik i efikasitetit të masave ekzistuese, ose masa të tjera shtesë, sipas rastit. Trajtimi i risqeve bëhet edhe përmes aktiviteteve të kontrollit që mund të jenë rregulla, procedura dhe veprime të cilat kanë për qëllim

¹⁸ Masat për trajtimin e risqeve përfshijnë: Masa për kufizimin ose uljen e riskut- planifikimi i kontrolleve që japin garanci të arsyeshme se risku kufizohet në parametra të pranueshëm në varësi të rëndësisë dhe kostove të kontrolleve. Risqet për të cilat adresohen masa të tilla kontrolli janë objekt monitorimi periodik; Transferimi i riskut- kryetari i bashkisë vlerëson se risku i lartë mund të transferohet në një institucion tjetër (me marrëveshje të përbashkët midis dy palëve); Tolerimi i riskut- kjo është masë që merret për risqet që kanë ndikim të kufizuar në arritjen e objektivave të bashkisë ose kur kostot e masave që parashikohen të merren janë në përpjesëtim të zhdrejtë me përfitimet e mundshme. Risqet, për të cilat adresohet kjo masë duhet të jenë në monitorim të vazhdueshëm. Mundësia që këto risqe të kalojnë në risqet prioritare është e lartë pasi ekziston mundësia që në ndikimin e faktorëve të ndryshëm (të brendshëm ose të jashtëm) të rritet mundësia e ndodhjes së ngjarjeve të padëshiruara dhe pasojave të tyre; Përfundimi i riskut- ka të bëjë me anashkalimin e disa risqeve duke hequr dorë përfundimisht nga objektivat që shoqërojnë këto risqe.

reduktimin e risqeve të integritetit për arritjen e objektivave. Aktivitetet e kontrollit të risqeve përfshijnë kontrolle parandaluese, korigjuese, drejtuese ose zbuluese.¹⁹

2.2.5 Plani i veprimit të menaxhimit të risqeve

Risqet e identifikuar sipas prioritetit dhe të shoqëruar me masat përkatëse janë pjesë e Planit të Veprimit të Menaxhimit të Riskut të Integritetit. Qëllimi i planit është dokumentimi i mënyrës sesi do të zbatohen masat e caktuara që përfshin: përshkrim të risqeve të identifikuar, objektiva të planit të veprimit, aktivitetet e propozuara, kostot financiare, personat përgjegjës si dhe afati i zbatimit (formati i Planit Model të Integritetit, kreu V i këtij dokumenti).

2.2.6 Monitorimi dhe raportimi i Planit të Veprimit-Plani i Integritetit

Zbatimi i Planit të Integritetit do të monitorohet në formë të planifikuar, periodikisht dhe do të përditësohet në përputhje me zhvillimet apo ndryshimet ligjore dhe nënligjore, institucionale, procedurale dhe të personelit që prekin funksionet dhe veprimtarinë e bashkisë.

Monitorimi i vazhdueshëm i zbatimit të Planit të Integritetit si një etapë e rëndësishme e ciklit të menaxhimit të risqeve të integritetit në bashki siguron që:

- aktivitetet e kontrollit dhe masat e trajtimit të risqeve të integritetit të jenë efektive në hartim dhe funksionim;
- procedurat të jenë të qarta;
- plani i integritetit shpallet në institucion.

Nga monitorimi do të përcaktohet nëse këto masa të zbatuara kanë qenë efikase, nëse kanë evidentuar ndryshime të kontekstit të bashkisë apo ndryshime të vetë risqeve, të cilat mund të kërkojnë rishikimin e masave ekzistuese dhe prioritetëve të risqeve si edhe të nxjerrim mësim për një planifikim më të mirë në të ardhmen. Përgjegjësitë për monitorimin e rregullt të Planit të Integritetit i caktohen një punonjësi të bashkisë nga kryetari i bashkisë.

¹⁹ Aktivitetet e kontrollit përfshijnë: *Aktivitete kontrolli parandaluese*: të cilat synojnë uljen e mundësisë së një rezultati të padëshiruara si p.sh. ndarja e detyrave mes stafit të një sektori ku çdo punonjës nuk vepron për një vendimmarrje të caktuar pa miratimin e punonjësi tjetër etj.; *Aktivitete kontrolli korigjuese*: të cilat synojnë korigjimin e rezultateve të padëshiruara dhe parashikojnë mënyrat për rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si p.sh. kushti i sigurimit të kontratave publike i cili mundëson pagimin e dëmit financiar në rast të ndodhjes së një risku; *Aktivitete drejtuese* të konceptuara për arritjen e një rezultati të caktuar (si p.sh. masat e sigurisë, apo kërkesat për ruajtjen e shëndetit dhe të jetës); ose që stafi të jetë trajnuar me aftësitë e kërkuara që të lejohet të punojë i pa mbikëqyrur; *Aktivitete kontrolli zbuluese* të konceptuara për të identifikuar rastet kur rezultatet e padëshiruara tashmë kanë ndodhur (p.sh kontrolle të rezervave, aktiveve apo procedurave të rakordimit).

Raportimi është një procedurë e rregullt që siguron zbatimin e planit të veprimit për risqet e integritetit sipas afateve kohore të parashikuara. Ky proces ndiqet nga personi përgjegjës i caktuar nga kryetari i bashkisë dhe që është përgjegjës për mbarëvajtjen e zbatimit. Raportimi bëhet të paktën një herë brenda periudhës tremujore. Ky raportim i bën të mundur kryetarit të bashkisë të ndërmarrë masa përkatëse në kohën e duhur në rast se zbatimi i ndonjë mase të caktuar ka sjellë vështirësi apo vonesa.

2.3 Metodatat e vlerësimit

Burimet që do të përdoren për vlerësimin e riskut të integritetit në bashki janë një kombinim i burimeve dytësore (analizë ligjore-institucionale dhe shqyrtim dokumentacioni) si dhe burimeve parësore (sondazhe dhe pyetësorë, fokuse grupe, intervista me drejtuesit kyç). Burimet dytësore do të përdoren në fazën paraprake të procesit të vlerësimit të riskut të integritetit në mënyrë që të përftohet një panoramë e përgjithshme qeverisjes dhe funksionimit të bashkisë si edhe në identifikimin e fushave të veprimtarisë më të ekspozuara ndaj riskut të integritetit. Burimet parësore do të përdoren për një analizë më të detajuar për risqet më kritike të integritetit, duke përfshirë edhe një analizë të specializuar në lidhje me nivelin e risqeve (mundësia e ndodhjes/shfaqjes së risqeve dhe ndikimi në integritetin e bashkisë). Ndërthurja e metodave sasiore me ato cilësore ofron një panoramë më të gjerë të riskut të integritetit në bashki dhe ndihmon për një analizë më të besueshme.

Për sa më sipër, metodatat që do të përdoren në vlerësimin e riskut të integritetit do të jenë:

- **Analiza e dokumenteve**, që është një metodë cilësore, përfshin analizën e të gjitha akteve ligjore në fuqi në lidhje me vetëqeverisjen vendore dhe kuadrin ligjor për integritetin, të kuadrin të brendshëm rregullator të bashkisë me fokus aktet administrative të nxjerra për administrimin e funksioneve për të cilat është përgjegjëse bashkia (si administrimi i shërbimeve publike, burimet financiare, burimet njerëzore), aktet administrative të nxjerra për të përcaktuar rregulla të përgjithshme dhe normative sjelljeje si dhe standarde të detyrueshme në përputhje me ligjin (për etikën, integritetin, konfliktin e interesave, deklarimin e pasurisë, parandalimin e korrupsionit); si dhe dokumentet politike kombëtare dhe vendore në lidhje me luftën kundër korrupsionit, dokumente të brendshme, si raporte të ndryshme vjetore, auditimi, etj., dhe dokumente të jashtme (raporte të KLSH, auditit i jashtëm) dhe informacioneve të tjera të nevojshme për të vlerësuar gjasat e risqeve të integritetit në bashki; gjetjet e mëparshme të auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.

- **Intervistat**, që janë një interpretim cilësor i gjetjeve, përfshin intervista me punonjës të bashkisë në sektorë të ndryshëm të saj, ballë për ballë, gjysmë të strukturuar. Punonjësit përzgjidhen sipas pozicionit të tyre në bashki, sipas përvojës e punës dhe nëpërmjet rekomandimeve (*snowballing*).
- **Sondazhet**, një metodë sasimore, përfshin pyetësorët, analizën statistikore të perceptimit të punonjësve të bashkisë nëpërmjet pyetësorëve të strukturuar për risqet e integritetit në bashkinë e tyre apo aktivitete të ekspozuara më së shumti ndaj korrupsionit. Një shembull pyetësori që mund të përdoret nga grupi i punës në bashki jepet në Shtojcën 1 të këtij dokumenti.

III. RISQET E INTEGRITETIT NË BASHKI

Bashkia si institucion përbëhet nga tërësia e:

1. aktorëve të saj: këshilli bashkiak që është organi përfaqësues, kryetari i bashkisë që është organi ekzekutiv dhe administrata e bashkisë;
2. fushave të veprimtarisë ose e funksioneve për të cilët bashkia është përgjegjëse dhe ka kompetencën ligjore për ti ushtruar ato;
3. mjedisit/kuadrit rregullator i cili në vetvete përbëhet nga parimet që përbëjnë standardet e sjelljes së aktorëve të bashkisë dhe nga rregullat e procedurat që përcaktojnë rrugët, strukturat dhe mënyrat e veprimit e të sjelljes së aktorëve të bashkisë në ushtrimin e funksioneve dhe në përmbushjen e parimeve.

Bashkia në mënyrë të vazhdueshme përballet me risqe të integritetit të saj. Mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje me ndikim në integritetin e bashkisë është e përditshme. Ngjarje të tilla ka gjasa të ndodhin në çdo fushë të veprimtarisë së bashkisë, ngjarje që mund të shkaktohen nga sjelljet, veprimet ose mos veprimet e aktorëve të bashkisë, ngjarje që favorizohen nga mungesa e mjedisit/kuadrit rregullator apo nga hapësirat që ka ky kuadër rregullator për të ndodhur ngjarje të tilla.

Më qëllim lehtësimin e identifikimit, vlerësimit, përcaktimin e aktorëve dhe përgjegjësi, monitorimin, ndërmarrjen e veprimeve për uljen apo parashikimin e ngjarjeve ose situatave potencialisht të dëmshme në arritjen e misionit dhe objektivave bashkisë, nga ana metodologjike, **veprimtaria e bashkisë mund të ndahet në shtatë fusha.**

Duke evidentuar dhe analizuar risqet sipas fushave të veprimtarisë në hapin e parë krijojmë të gjitha premiset dhe mundësitë për te evidentuar, analizuar dhe trajtuar risqet e integritetit në nivelin institucioni, pra në nivel bashkie. Këto fushat janë:

3.1 Fusha e menaxhimit financiar (buxheti, të ardhurat dhe shpenzimet)

Kjo është një fushë me risqe të shumta dhe me ndikime të mëdha. Risqet mund të ndodhin si në planifikimin dhe grumbullimin e burimeve financiare ashtu dhe në përdorimin e tyre. Në këtë fushë dhe në fushat e tjerë ka gjasa të ndodhin ngjarje/risqe të brendshme dhe të jashtme, risqe mashtrimi apo korrupsioni, risqe investimi, detyrimesh, reputacioni etj.

Për t'u kuptuar më lehtë, po japim një shembull: Bashkia ka gjasa që të përballet me mos miratimi brenda afateve ligjore të buxhetit nga ana e këshillit të bashkisë. Ky është një risk, një ngjarje, që sjell disa ndikime apo pasoja negative siç mund të jetë mungesa e fondeve për të paguar kontratat në kohë, mungesa e fondeve për investimeve në kohë në kopshte, çerdhe, shkolla, rrugë, shërbime etj. Mungesa e fondeve në kohë sjell uljen e cilësisë, standardeve dhe performancës së shërbimeve, mund të sjell cenim të reputacionit të bashkisë dhe humbjen e besimit tek qytetarët.

Për qëllime metodologjike, në tabelat në vijim po japim elementët përbërës por pa u kufizuar në këto, të fushës së menaxhimit financiare dhe të fushave të tjera. Kjo do të na mundësojë evidentimin më lehtë të risqeve dhe ndikimeve të tyre, evidentimin e aktorëve që me veprimet ose mosveprimet janë shkaktar të këtyre risqeve dhe evidentimin më lehtë të masave për trajtimin e risqeve.

Tabela 5. Fusha e menaxhimit financiar

Emërtimi	Ngjarje negative që mund të ndodhin/ Risqet	Mundësia e ndodhjes për çdo risk	Ndikimi i riskut në integritetin e bashkisë
Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i planit strategjik të zhvillimit të bashkisë	1. _____ 2. _____ 3. _____	<ul style="list-style-type: none"> ▪ E shpeshtë ▪ E mundshme ▪ E rrallë 	<ul style="list-style-type: none"> ▪ I lartë ▪ I moderuar ▪ I ulët
Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i programit buxhetor afatmesëm			
Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i buxhetit vjetor të bashkisë			
Përgatitja, miratimi dhe publikimi i taksave e tarifave vendore			
Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i rregullave dhe procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve			
Përgatitja, miratimi dhe zbatimi i normave dhe rregullave për ruajtjen dhe administrimin e dokumenteve financiare			

Përgatitja dhe miratimi i regjistrit të parashikimeve të prokurimeve publike dhe realizimi i tyre			
Ngritja dhe funksionimi i komisionit të vlerësimit të ofertave dhe të njësisë së prokurimeve			
Përgatitja, miratimi dhe publikimi çdo muaj (pas datës 30 prill të çdo viti buxhetor) të raporteve të përmbledhura mbi ecurinë e realizimit të treguesve kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas planit vjetor dhe planit të periudhës			
Përgatitja, miratimi dhe publikimi i raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit vendor			
Përgatitja, miratimi dhe publikimi i raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit			

3.2 Fusha e menaxhimit të burimeve njerëzore

Kjo është një fushë e rëndësishme e bashkisë, në të cilën mund të ndodhin ngjarje me ndikime të shumta negative. Një seri ngjarjesh mund të ndodhin në emërimin, zgjedhjen, transferimin, shkarkimin e personelit, në miratimin, zbatimin apo ndryshimin e strukturës organizative, të rregulloreve dhe kodeve të ndryshme dhe që sjellin ndikime në integritetin e bashkisë.

Tabela 6. Elementët e fushës së burimeve njerëzore

Emërtimi	Ngjarje negative që mund të ndodhin/ Risqet	Mundësia e ndodhjes (për çdo risk)	Ndikimi i riskut në integritetin e bashkisë
Krijimi dhe funksionimi i njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore	1. _____ 2. _____ 3. _____	a) E shpeshtë b) E mundshme c) E rrallë	a) I lartë b) I moderuar c) I ulët
Krijimi dhe funksionimi i Komisionit të Përhershëm të Pranimit në kategorinë ekzekutive			
Krijimi dhe funksionimi i komisionit disiplinor			
Krijimi dhe administrimi i dosjeve të personelit për çdo të punësuar			
Ngritja dhe funksionimi i sistemit të vlerësimit të rezultateve në punë			
Hartimi, miratimi, zbatimi dhe monitorimi i rregullores bazë të administratës së bashkisë dhe të njësisë e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë			
Hartimi dhe miratimi i strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i planit/programit për kualifikimin dhe trajnimin të administratës			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i kodit të sjelljes			
Caktimi i koordinatorit për të drejtën e informimit dhe miratimi i detyrave, përgjegjësisë dhe ndërveprimit me strukturat e tjera të bashkisë			
Caktimi i koordinatorit për njoftimit dhe konsultimit publik dhe në miratimin detyrave, përgjegjësisë dhe ndërveprimit me			

strukturat e tjera të bashkisë			
Ngritja dhe funksionimi i autoritetit përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave në Bashki			
Hartimi dhe miratimi i detyrave, funksioneve dhe përgjegjësisë të Autoritetit Përgjegjës për parandalimin e konfliktit të interesave			
Krijimi dhe administrimi i regjistrit të konfliktit të interesit			
Ngritja dhe funksionimi i njësisë përgjegjëse e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet për veprime ose praktika të dyshuar korrupsioni			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullores së brendshme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi			

3.3 Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit.

Kjo fushë në thelb nga njëra anë ka si mision trajtimin e risqeve të ndryshme me të cilat përballet bashkia dhe nga ana tjetër ajo vetë përballet me shume risqe dhe

ndikime negative. Ngjarje të shumta negative mund të ndodhin në ngritjen dhe funksionimin e auditimit të brendshëm dhe sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregulloreve dhe kodeve të ndryshme etj. Në vijim tabela me elementët përbërës por pa u kufizuar vetëm tek këto të kësaj fushe:

Tabela 7. Fusha e kontrollit, auditimit dhe të mekanizmave kundër korrupsionit

Emërtimi	Ngjarje negative që mund të ndodhin/ Risqet	Mundësia e ndodhjes (për çdo risk)	Ndikimi i riskut në integritetin e bashkisë
Ngritja dhe funksionimi i shërbimit të auditimit të brendshëm	1. _____ 2. _____ 3. _____	a) E shpeshtë b) E mundshme c) E rrallë	a) I lartë b) I moderuar c) I ulët
Ngritja dhe funksionimi i sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin (MFK)			
Ngritja dhe funksionimi i Grupit për Menaxhimit Strategjikë			
Hartimi dhe miratimi me akt administrativ të "Kartës së Auditimit" mbi statusit organizativ, qëllimin, misionin, objektivat e punës, përgjegjshmëria dhe përgjegjësitë e njësisë së auditimit të brendshëm			
Hartimi dhe miratimi i gjurmëve të auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të bashkisë			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i veprimtarive të kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara			
Ngritja dhe funksionimi i njësisë përgjegjëse e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet për veprime ose praktika të dyshuar korrupsioni			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregulloreve të			

brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullave dhe normave të brendshme për shmangien e konfliktit të interesit			
Hartimi, miratimi me akt administrative të “Kodit të Etikës” dhe zbatimi i rregullave të sjelljes dhe parimeve që duhet të udhëheqin punën e audituesve të brendshëm			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullave të brendshme për mënyrat e ndarjes informacionit dhe komunikimit mes aktorëve të bashkisë dhe niveleve të ndryshme të administratës të raporteve të kontrollit të jashtëm apo auditimit të brendshëm si dhe të vendosjes së tyre në dispozicion të publikut			
Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm kontrolli (Përfshirë integritetin personal dhe etikën profesionale; politikat menaxheriale dhe stilin e			

punës; strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit; politikat dhe praktikatat e menaxhimit të burimeve njerëzore)			
---	--	--	--

3.4 Fusha e shërbimeve publike

Misioni i bashkisë është të sigurojë qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve, ndër të tjera, nëpërmjet:

1. Zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;
2. Realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë; dhe
3. realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative (neni 3 i ligjit 139/2015). Bashkia në ofrimin e shërbimeve publike duhet të siguroj aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e përballeshme nga të gjithë qytetarët (neni 32/1 i ligjit 139/2015).

Ngjarje të shumta me ndikime/pasoja negative mund të ndodhin në fushën e shërbimeve si në zgjedhjen e instrumentit për administrimin e shërbimit publik, përcaktimin e treguesve, standardeve të shërbimeve, ngritjen dhe funksionimin e strukturave përkatëse, në ofrimin në kohë të shërbimeve, në aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston e shërbimit. Në vijim tabela jepet me elementët përbërës të kësaj fushe por pa u kufizuar vetëm tek këto elemente.

Tabela 8. Fusha e shërbimeve publike²⁰

Emërtimi	Ngjarje negative që mund të ndodhin/ Risqet	Mundësia e ndodhjes (për çdo risk)	Ndikimi i riskut në integritetin e bashkisë
Hartimi, miratimi, zbatimi dhe monitorimi i objektivave dhe masave për përmbushjen e detyrimeve ligjore në ofrimin e shërbimeve	1. _____ 2. _____ 3. _____	a) E shpeshtë b) E mundshme c) E rrallë	a) I lartë b) I moderuar c) I ulët
Planifikimi dhe financimi i shërbimit			

²⁰ Analiza kryhet për të gjitha shërbimet (administrative dhe publike) të ofruara nga bashkia

Hartimi dhe përzgjedhja e instrumentit për administrimin e shërbimit publik			
Hartimi dhe vendosja e një sistemi administrimi të performancës së shërbimit, bazuar mbi standarde			
Hartimi dhe vendosja e një sistemi treguesish për shërbimin			
Ngritja dhe funksionimi i strukturës përgjegjëse për prezantimin, mbikëqyrjen dhe monitorimin e performancës e të shërbimit			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullave, normave dhe procedurave për lëshimin e lejeve/ licencave			
Hartimi dhe miratimi i një linje të qartë detyrash dhe përgjegjësish për përgatitjen e termave të referencës, hartimin, miratimin, nënshkrimin dhe monitorimin e kontratave publike			
Ngritja dhe funksionimi i njësisë përgjegjëse e cila regjistron, heton administrativisht dhe shqyrton sinjalizimet për veprime ose praktika të dyshuar korrupsioni			
Ngritja dhe funksionimi i strukturës publike përgjegjëse për mbikëqyrjen dhe monitorimin e kontratës për ofrimin e shërbimet publik			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullave dhe			

procedurave për marrjen, vlerësimin, trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesave, ankesave, sinjalizimeve apo vërejtje në lidhje me aksesin, cilësinë, sasinë dhe koston shërbimit publik?			
Ngritja dhe funksionimi i një sistemi informimi dhe komunikimi të raporteve të kontrollit dhe auditimit të shërbimeve publike si dhe të një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullave dhe normave të brendshme për shmangien e konfliktit të interesit në fushën e ofrimit të shërbimit			

3.5 Fusha e administrimit dhe menaxhimi i pronave

Bashkia ushtron të drejtën e pronësisë. Ajo fiton, shet dhe jep në përdorim pronën e paluajtshme ose të luajtshme të saj. E drejta e pronësisë ushtrohet nga këshilli bashkiak. Menaxhimi i pronave është burim kryesor i të ardhurave në bashki. Ngjarje të shumta me ndikime/pasoja negative mund të ndodhin në këtë fushë si në administrimin e pronave, kontratave, në tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve, në ngritjen dhe funksionimin e strukturave përkatëse, etj. Në vijim jepet tabela me elementët përbërës të kësaj fushe por pa u kufizuar vetëm tek këto elementë.

Tabela 9. Fusha e administrimit dhe menaxhimi i pronave

Emërtimi	Ngjarje negative që mund të ndodhin/ Risqet	Mundësia e ndodhjes (për çdo risk)	Ndikimi i riskut në integritetin e bashkisë
Ngritje dhe funksionimi i njësisë së administrimit të pronave bashkiake	1. _____ 2. _____ 3. _____	a) E shpeshtë b) E mundshme c) E rrallë	a) I lartë b) I moderuar c) I ulët
Krijimi dhe funksionimi i sistemit të informacionit për administrimin dhe			

përdorimin e pronave bashkiake			
Hartimi, miratimi, zbatimi dhe monitorimi i strategjisë së administrimit të pronave bashkiake			
Krijimi dhe administrimi i regjistrit të kontratave për pronat në pronësi ose administrim të Bashkisë			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i procedurave administrative në trajtimin e ankesave dhe kërkesave të qytetarëve në administrimin e pronave bashkiake			
Këshillimi me bashkësinë dhe miratimi i tjetërsimit ose dhënia në përdorim të pronave të tretëve			
Informimi dhe komunikimi me publikun mbi administrimit të pronave bashkiake (gjendja, përdorimi, të ardhurat dhe shpenzimet për administrimin e tyre)			

3.6 Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimi të territorit

Kjo është një fushë e rëndësishme në veprimtarinë e bashkisë nëpërmjet të cilës bashkia ndër të tjera duhet të siguroj zhvillimin e qëndrueshëm të territorit, mbrojtjen e burimeve natyrore, të krijojë kushte të përshtatshme dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, kohezion ekonomik e social dhe gëzim të të drejtave të pronësisë. Kjo është një fushë në të cilën mund të ndodhin ngjarje të shumta me ndikime/pasoja negative si në hartimin, miratimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit dhe zhvillimit të territorit ashtu dhe në dhënien e lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit. Në vijim tabela me elementët përbërës të kësaj fushe por pa u kufizuar vetëm tek këto.

Tabela 10. Fusha e planifikimit, administrimit dhe zhvillimi i territorit

Emërtimi	Ngjarje negative që mund të ndodhin/ Risqet	Mundësia e ndodhjes (për çdo risk)	Ndikimi i riskut në integritetin e bashkisë
Hartimi, miratimi, monitorimi dhe mbikëqyrja e planit të përgjithshëm vendor	1. _____ 2. _____ 3. _____	a) E shpeshtë b) E mundshme c) E rrallë	a) I lartë b) I moderuar c) I ulët
Hartimi, miratimi, monitorimi dhe mbikëqyrja e planit të detajuar vendor			
Publikimi dhe këshillimi me publikun i dokumenteve vendorë të planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit			
Dhënia e lejeve të zhvillimit, lejeve të ndërtimit dhe dhënien e certifikatës së përdorimit			
Pagesa dhe administrimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja			
Ngritja dhe funksionimi i Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit në Bashki			
Kontrolli i zhvillimit të territorit dhe të ndërtimeve			

3.7 Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronik

Edhe kjo është një fushë me rëndësi në veprimtarinë e bashkisë. Nga njëra anë kjo fushë përmban kujtesën e bashkisë dhe nga ana tjetër është puna e përditshme me dokumentin, me aktet administrative, me sistemet dhe shërbimet e elektronike. Ngjarje me ndikime/pasoja negative janë të shumta në këtë fushë. Këto ngjarje janë të lidhura më krijimin dhe funksionimin e arkivit, menaxhimin/administrimin e fondit arkivor, me krijimin dhe mirëmbajtjen e sistemeve të informacionit elektronik, me hartimin, miratimin dhe zbatimin e rregulloreve dhe manualeve të ndryshme. Më poshtë jepet tabela me elementët përbërës të kësaj fushe por pa u kufizuar vetëm tek këto.

Tabela 11. Fusha e arkivimit, ruajtjes dhe administrimit të dokumenteve si dhe të informacionit, dhe të dokumenteve elektronik

Emërtimi	Ngjarje negative që mund të ndodhin/ Risqet	Mundësia e ndodhjes (për çdo risk)	Ndikimi i riskut në integritetin e bashkisë
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i rregullores së brendshme për zbatimin e legjislacionit për arkivat	1. _____ 2. _____ 3. _____	a) E shpeshtë b) E mundshme c) E rrallë	a) I lartë b) I moderuar c) I ulët
Menaxhimi/administrimi i fondit arkivor bashkiak			
Ngritja dhe funksionimi i Arkivit			
Ngritja dhe funksionimi i Komisionit të Ekspertizës			
Krijimi dhe përdorimi i modelit të njëzuar të dokumentit administrativ në bashki			
Ngritja dhe funksionimi i sekretarisë dhe arkivit, pjesë strukturore që përgjigjet për administrimin e dokumenteve të krijuara, apo të ardhura në adresë të bashkisë			
Zhvillimi dhe mirëmbajtja e sistemeve elektronike			
Ngritja dhe funksionimi i njësisë për informacionin, komunikimin dhe sigurinë e informacionit e të dokumenteve elektronik			
Krijimi dhe mirëmbajtja e sistemeve të informacionit (asetet e informacionit, programet, asetet fizike, shërbimet)			
Hartimi, miratimi dhe zbatimi i manualeve të punës dhe të punësimit në sistemet e informacionit			
Menaxhimi i riskut për sistemet e informacionit			

IV. PROCESI I VLERËSIMIT TË RISKUT TË INTEGRITETIT NË BASHKI

Procesi i Vlerësimit të Riskut të Integritetit në bashki përbëhet nga 5 faza që në mënyrë të hollësishme jepen më poshtë, ndërsa në mënyrë të përmbledhur në paraqiten në tabelën 12 të këtij kreu. Si proces vetëvlerësimi, ai nisët nga kryetari i bashkisë me ngritjen e një grupi pune për vlerësimin e riskut të integritetit dhe përgatitjen e planit të integritetit të bashkisë. Ky plan integriteti miratohet në këshillin bashkiak.

Faza 1: Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore

Kryetari i Bashkisë ngre një grup pune integriteti (GPI) për realizimin e vlerësimit të riskut në bashki. Grupi ka në përbërje koordinatorin e riskut në bashki, drejtuesit e drejtorive të bashkisë, përfaqësues të njësisë së parandalimit të konfliktit të interesit, kreun e njësisë së sinjalizimit në bashki; kreun e njësisë së auditimit të brendshëm; koordinatorin e transparencës dhe koordinatorin e njoftimit dhe konsultimit publik. Grupi i punës kryesohet nga një koordinator. Nën drejtimin e tij/saj, grupi i punës merr detyrat për të gjithë procesin që lidhet me përgatitjen e regjistrit të risqeve dhe planin e veprimit për menaxhimin e risqeve të integritetit.

Kryetari i bashkisë për hartimin në kohë, miratimin dhe zbatimin e planit të veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit angazhohet për sa më poshtë:

- Informon në kohë të gjithë punonjësit e bashkisë për ngritjen e një grupi pune për vlerësimin e riskut të integritetit, në mënyrë që të sigurohet mbështetja e të gjithë punonjësve të bashkisë për koordinatorin dhe anëtarët e tjerë të GPI-së;
- Siguron që koordinatori dhe anëtarët e tjerë të GPI-së të kenë kohë të mjaftueshme për të kryer detyrat që lidhen me realizimin e VRI-së.

Grupi i punës së bashku me kryetarin e bashkisë prezanton përpara punonjësve të tjerë të bashkisë termat, objektivat, rëndësinë dhe mënyrën e zhvillimit të planit të integritetit përmes:

- Takimeve/mbledhjeve me punonjës të bashkisë;
- Publikimit të njoftimeve mbi Planin e Integritetit në këndin njoftimeve publike në bashki;
- Komunikim me e-mail;
- Takime apo mbledhje sipas drejtorive/sectorëve të bashkisë.

Koordinatori menaxhon punën e grupit të punës dhe është përgjegjës për monitorimin dhe kryerjen e detyrave të përcaktuara në vendimin e kryetarit të bashkisë dhe programit të punës të miratuar nga GPI. Grupi i punës harton një program pune me detyra dhe përgjegjësi për GPI dhe afate të mirë përcaktuara (sipas modelit në kreun V). Koordinatori i grupit të punës informon të gjithë të punësuarit në bashki, aktorët e bashkisë si këshillin bashkiak, kryetarin e bashkisë, administratën e bashkisë si dhe institucionet/njësitë e varësisë dhe subjektet që ofrojnë shërbime/mallra në emër të bashkisë, publikun dhe grupet e interesit, mbi aktivitetet e planifikuara në zhvillimin e vlerësimit të riskut të integritetit dhe metodave përkatëse të vlerësimit.

Faza 2: Identifikimi dhe analiza e riskut

Kjo fazë fillon me ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të grupit të punës përmes sesioneve të trajnimeve në module për:

1. integritetin, etikën dhe korrupsionin;
2. procesin e identifikimit, analizimit dhe vlerësimin e risqeve sipas fushave të veprimtarisë së bashkisë; dhe
3. modelin e planit të integritetit.

GPI vijon me identifikimin e objektivave strategjike, programore dhe operationale të bashkisë dhe më pas me identifikimin e risqeve në mbështetje të kuadrit teorik të metodologjisë (seksioni 2.2) dhe të elementëve të fushave të veprimtarisë së bashkisë të përcaktuara në Kreun III të këtij dokumenti.

GPI vijon të identifikojë dhe vlerësojë masat ekzistuese për menaxhimin e riskut në nivel bashkie, nëse janë zbatuar dhe nëse është arritur efekti i pritshëm nga zbatimi i tyre. Risqet e identifikuara, faktorët e tyre, mundësia e ndodhjes dhe ndikimi që krijojnë në integritetin e bashkisë, si dhe trajtimi i tyre diskutohen nga GPI në nivel drejtorie/sektori të bashkisë.

Në këtë fazë GPI i kushton vëmendje të veçantë kuadrit ligjor, nënligjor dhe atij rregullator për parandalimin e shfaqjes dhe zhvillimit të korrupsionit, sjelljes korruptive, jo-etike dhe jo-profesionale, si dhe mbi parregullsi të tjera në fushat e funksionit të bashkisë. Gjithashtu, të dhënat që do të rezultojnë nga pyetëtori anonim i plotësuar nga të gjithë punonjësit e bashkisë do të jenë pjesë e punës së kësaj faze. (Pyetëtori jepet në Shtojcën 1 të këtij dokumenti). GPI shpërndan pyetëSORIN, i cili plotësohet në mënyrë elektronike/shkresore (sipas rastit) dhe përcakton afatin kohor 3-5 ditë për plotësimin e tij.

Faza 3: Vlerësimi i risqeve të integritetit dhe trajtimi i tyre

Kjo fazë ka të bëjë në thelb me vlerësimin e intensitetit të risqeve të identifikuar nëse ato do të pranohen apo do të trajtohen me masat përkatëse. Kjo fazë vijon me renditjen e risqeve të integritetit sipas prioriteteve (rezultatet sipas matricës së riskut). GPI përcakton se cilat risqe do të ndiqen me përparësi duke vënë në dispozicion burimet ekzistuese të bashkisë për trajtimin e tyre.

Faza 4: Plani i Veprimit për Menaxhimin e Riskut dhe Regjistri i Riskut

Në këtë fazë grupi i punës harton një vlerësim përfundimtar për çdo risk të identifikuar. Po ashtu, GPI harton një plan veprimi për menaxhimin e risqeve të identifikuar, plan që përmban masa konkrete për të përmirësuar integritetin e bashkisë. Masat propozohen në varësi të intensitetit të riskut, me prioritet të lartë, të moderuar ose të ulët. Nëse risku është i lartë, atëherë nevojitet të merret një masë me prioritet të lartë si dhe duke mbajtur në konsideratë faktorët e riskut. Që këto masa të jenë efikase, është e nevojshme të përcaktohet për secilën masë personi përgjegjës si dhe afatet për zbatimin e saj. (Shih Kreu V. Plani model i integritetit: formati i regjistrit të riskut dhe planit të veprimit.)

Gjatë kësaj faze, GPI harton një raport për gjendjen e integritetit të institucionit. Qëllimi i raportit është të bëjë të ditur situatën e integritetit të bashkisë, aktivitetet e ndërmarra nga grupi i punës si dhe masat e propozuara për përmirësimin e integritetit. Struktura e raportit përbëhet nga: vlerësimi fillestar i gjendjes së integritetit të institucionit të bashkisë; rezultatet nga përpunimi i të dhënave të pyetësorit të realizuar me punonjësit e bashkisë; dhe të dhëna (përshkrimi) për risqet e identifikuar si dhe vlerësimi i intensitetit të tyre.

Konsolidimi i Planit të Integritetit. GPI konsolidon të gjithë dokumentacionin e përpiluar në kuadër të këtij procesi sipas planit model të integritetit, që jepet në Kreun V të këtij dokumenti. Ky plan, pasi kalon një proces konsultimi me të gjithë aktorët e bashkisë, me aktorë të tjerë të tjerë të interesuar dhe publikun, i paraqitet për miratim Këshillit Bashkiak si organi vendimmarrës i bashkisë.

Faza 5: Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi dhe raportimi në vazhdimësi ndihmojnë për të kuptuar nëse risqet e identifikuar janë menaxhuar në mënyrë të efektshme, nëse kanë pësuar

ndryshime të profilit të tyre, nëse janë zvogëluar apo zmadhuar. Kjo fazë realizohet në përputhje me përcaktimet e bëra në seksionin 2.2.6 të Kreut II dhe përfshin:

- a) Zhvillimin e mekanizmave për zbatimin e Planit të Menaxhimit të Riskut në Bashki;
- b) Emërimin e një personi përgjegjës nga kryetari i bashkisë për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit (në veçanti mbi masat e përcaktuara për përmirësimin integritetit);
- c) Informimin e organit ekzekutiv dhe përfaqësues të bashkisë rregullisht për çështje apo zhvillime që lidhen me planin e menaxhimit të riskut;
- d) Përditësimin e regjistrit të riskut rregullisht dhe vazhdimisht;
- e) Përlllogaritjen e efekteve financiare që mund të sjelli krijimi i mekanizmave për zbatimin e Planit të Integritetit apo implikime që mund të vijnë nga ndryshime të profilit të risqeve, të cilat mund të kërkojnë marrjen e masave të menjëhershme;
- f) Përcaktimin e rregullave të qarta, detyrave, personave përgjegjës, dhe afateve për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit (në rregulloren e brendshme të bashkisë).
- g) Krijimin e mekanizmave efektivë të komunikimit ndërmjet personit përgjegjës për integritetin, organit përfaqësues dhe ekzekutiv të bashkisë si edhe me administratën e bashkisë.

Në këtë fazë, punonjësit e bashkisë janë të detyruar të:

- a) informojnë personin përgjegjës për monitorimin e zbatimit të planit, në lidhje me dukuri apo veprime të cilat, mund të çojnë në formimin e zhvillimin e riskut të integritetit, sjelljes korruptuese, jo-etike dhe jo profesionale, praktika dhe parregullsi të tjera në punën e bashkisë; dhe
- b) ofrojnë të dhëna dhe informacione me rëndësi të nevojshme për zbatimin e planit të menaxhimit të riskut të integritetit.

Tabela nr.12: Hapat për realizimin e Procesit të Vlerësimit të Riskut të Integritetit

Nr.	Aktiviteti	Personat/Institucionet përgjegjës
Faza 1. Përgatitja, komunikimi dhe mobilizimi i burimeve njerëzore: Rezultat i kësaj faze është hartimi dhe miratimi i një plani pune për vlerësimin e risqeve të integritetit. Plan i punës përmban përshkrimin e përgjegjësive për personat e përfshirë në këtë proces dhe afate për kryerjen e tyre.		
1	Angazhim i nivelit të lartë drejtues dhe përfaqësues (këshilli bashkiak dhe kryetari) për realizimin e procesit të VRI.	Kryetari
2	Ngritja e grupit të punës që do të kryejë VRI në bashki	Kryetari
3	Hartimi dhe miratimi i përgjegjësive të grupit të punës (plani i punës).	GPI

4	Vlerësimi i kuadrit ligjor dhe atij të brendshëm rregullator të bashkisë për integritetin. Vlerësim i strukturave organizative të bashkisë.	GPI
5	Hartimi dhe miratimi i “ paketës institucionale”.	GPI dhe Këshilli Bashkiak
Faza 2: Identifikimi dhe analizimi risqeve të integritetit: Rezultati i kësaj faze është hartimi i një liste të risqeve të identifikuara dhe vlerësimi se cilat risqe janë ose jo nën kontroll si dhe mënyrat për menaxhimin e tyre.		
1	Trajnime (ndërtim kapacitetesh) për procesin e vetëvlerësimit të integritetit dhe metodologjinë VRI	GPI
2	Vendosja e objektivave strategjike, programore dhe operacionale të bashkisë; Identifikimi i elementëve të fushave të veprimtarisë së bashkisë që mund të jenë të riskuara ndaj korrupsionit, shkeljeve të integritetit, sjelljeve jo etike e jo profesionale dhe parregullsive të tjera.	GPI
3	Identifikimi i risqeve të integritetit sipas fushave të veprimtarisë së, identifikimi i faktorëve të risqeve duke marrë në konsideratë mundësinë e ndodhjes apo shfaqjes së risqeve si dhe ndikimin e tyre në integritetin e bashkisë.	GPI
4	Identifikim i risqeve që duhet të menaxhohen dhe vlerësimi i mekanizmave ekzistues të kontrollit.	GPI
5	Realizimi i sondazhit mbi integritetin (me pyetësorë) me punonjësit e bashkisë.	GPI
Faza 3: Vlerësimi i risqeve të integritetit: Rezultati është vlerësimi përfundimtar për secilin risk		
1	Vlerësimi i intensitetit të risqeve të identifikuara dhe ndërveprimi i tyre i mundshëm	GPI
2	Renditja e risqeve të identifikuara sipas përparësisë	GPI
3	Hartimi i raportit të vlerësimit të risqeve	GPI
Faza 4: Plani i veprimit për Menaxhimin të Riskut dhe Regjistri i Riskut : në fund të kësaj faze hartohet një plan veprimi i menaxhimit të risqeve/ plani i integritetit		
1	Hartimi i Regjistrin të Riskut, i cili përfshin një përshkrim të detajuar të gjithë risqeve të identifikuar. Bazuar në interpretimin dhe rekomandimet e ofruara gjatë fazës së vlerësimit, hartohet Plani i Veprimit për Menaxhimin e Risqeve i cili përfshin: - Trajtimin mbi risqet (masat) dhe aktivitetet e kontrollit; - Efektet financiare të nevojshme për realizimin e masave (nëse ka); - Rekomandime për përmirësimin e aktiviteteve të kryera nga bashkia në kuadër të fushave të veprimtarisë së saj; - Rregulla mbi zbatimin e masave për kontrollin e risqeve të identifikuara.	GPI
2	Përgatitja e raportit përfundimtar mbi gjendjen e integritetit në bashki	GPI

3	Hartimi i Planit të Integritetit (me konsolidim e të gjitha dokumenteve të hartuara në kuadër të procesit të VRI: plani i veprimit të menaxhimit të risqeve, regjistri i riskut, raporti përfundimtar i integritetit) dhe dorëzimi i tij te Këshilli Bashkiak	GPI dhe Kryetari
4	Prezantimi i Planit të Integritetit për të gjithë punonjësit, publikun dhe aktorët e tjerë të përfshirë në proces	GPI, Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak
5	Miratimi i Planit të Integritetit	Këshilli Bashkiak
Faza 5: Monitorimi dhe Raportimi: rezultati final është caktimi i një instrumenti dhe një sistemi të vlerësimit të planit të integritetit		
1	Ngritja e një sistemi monitorues të bazuar në evidencë mbi progresin e zhvillimit të integritetit.	GPI dhe Kryetari
2	Emërimi i koordinatorit të integritetit.	Kryetari
3	Informim periodik, i departamenteve brenda bashkisë, ekzekutivit të bashkisë dhe këshillit bashkiak, mbi zbatimin e planit të integritetit.	Koordinatori i Integritetit dhe ose punonjësit përgjegjës në stafin bashkiak
4	Hartimi dhe vënia në funksion e instrumenteve të komunikimit ndërmjet koordinatorit të integritetit, ekzekutivit të bashkisë dhe administratës së bashkisë	Kryetari dhe Koordinatori i Integritetit

V. MODELI I PLANIT TË INTEGRITETIT PËR BASHKINË

Plani i Integritetit është një mjet i cili i shërben njësive të vetëqeverisjes vendore (NJVV) të identifikojnë, vlerësojnë dhe parandalojnë tërësinë e rreziqeve që cenojnë integritetin e institucionit dhe individëve që punojnë në të. Plani i Integritetit është një proces i dokumentuar që vlerëson nivelin e cenueshmërisë së një organizate dhe ekspozimin e saj ndaj korrupsionit dhe praktikave jo-etike dhe jo-profesionale.

Qëllimi i Plani i Integritetit

Plani i Integritetit ka për qëllim eliminimin e shkaqeve ose rreziqeve për shfaqjen dhe zhvillimin e korrupsionit dhe gjithë sjelljeve etike dhe profesionale të papranueshme. Ai mundëson sinergji të vlefshme, bazuar në profesionalizmin e punonjësve të bashkisë duke kombinuar kështu punonjësit me përvojë dhe të rinjtë që punojnë në administratën e bashkisë.

Plani i Integritetit synon të krijojë një mënyrë sistematike të identifikimit të të gjitha proceseve dhe praktikave që janë në kompleks të administruara nga institucioni. Ky plan qartëson dhe ndërgjegjëson në mënyrë të vazhdueshme për rolin dhe përgjegjësitë e secilit punonjës brenda strukturave. Ai është mjeti më efektiv për identifikimin e rreziqeve që cenojnë mbarëvajtjen e proceseve kryesore të administruara nga bashkia. Nëpërmjet këtij instrumenti bëhet e mundur përfshirja e gjithsecilit në hartimin e planeve të veprimit, që do të parandalonin, kufizonin apo minimizonin kushtet për shfaqjen e korrupsionit, praktikave jo-etike dhe jo-profesionale në të gjitha fushat e përgjegjësve të bashkisë. Ky plan do të ndihmonte në aspektin praktik duke u mundësuar të gjitha niveleve të propozojnë masa dhe aktivitete të përshtatshme për zvogëlimin ose eliminimin e këtyre rreziqeve që kanë mundur të identifikojnë.

Qëllimi përfundimtar i hartimit të Planit të Integritetit është forcimi i integritetit institucional duke vënë theksin te ndershmëria, profesionalizmi, etika personale dhe mënyra e të vepruarit në përputhje me vlerat morale të komunitetit.

Avantazhet e zbatimit të Planit i Integritetit

Plani i Integritetit prodhon një tërësi planesh veprimi të cilat krijojnë një dinamikë që ndihmon menaxhimin me efikasitet të bashkisë dhe kontribuon pozitivisht që

ato të jenë të fokusuara kryesisht te rreziqet që kanosin institucionin në mënyrë të vazhdueshme.

Zbatimi dhe përditësimi i këtyre planeve të veprimit ndihmon në ndërtimin dhe forcimin e një kulture organizative e cila krijon rezistencë ndaj praktikave korruptive. Një nga ndikimet kryesore e më të vlefshme të Planit të Integritetit është forcimi dhe ndërgjegjësimi i mëtejshëm i të gjitha niveleve të drejtimit drejt një kulture mospranuese dhe parandaluese të korrupsionit. Plani i Integritetit ndërgjegjëson institucionin në lidhje me risqet organizative ndaj shkeljeve të integritetit si dhe përcaktimin e masave me qëllimin e rritjes së rezistencës së organizatës ndaj korrupsionit (Minkova: 2015). Ai përbën një mekanizëm i cili nxit menaxhimin efektiv institucional dhe kontribuon në mirë qeverisjen e strukturave si një e tërë.

Plani i Integritetit nxit transparencën ndaj palëve të treta e kryesisht komunitetit, ashtu sikurse zhvillon një ndërgjegjësim të vazhdueshëm mbi llogaridhënien dhe promovimin e sjelljeve etike në nivelet e synuara.

Rezultati përfundimtar i zbatimit të Planit të Integritetit do të ishte: thjeshtimi i mëtejshëm i procedurave dhe proceseve komplekse, përmirësimi dhe ndërtimi i një sistemi efektiv i kontrollit të brendshëm, përforcimi e llogaridhënies, rritja e transparencës, përmirësimi i profesionalizmit dhe standardeve të etikës.

Pjesët përbërëse të Planit të Integritetit janë:

- a) Informacionin bazë për institucionin dhe grupin i punës për zhvillimin e një plani integriteti;
- b) Urdhër për hartimin e një plani të integritetit për bashkinë;
- c) Njoftimi për punonjësit e bashkisë për zhvillimin e një plani integriteti;
- d) Programi i punës i grupit të punës për zhvillimin e një plani integriteti;
- e) Përshkrim i risqeve të identifikuara, analizuara dhe të vlerësuara;
- f) Masat dhe rekomandimet për trajtimin e risqeve sipas prioriteteve;
- g) Vendimi i këshillit bashkiak për miratimin dhe zbatimin e planit të integritetit në bashki.

5.1 Informacion bazë për institucionin dhe personat përgjegjës për përgatitjen dhe zbatimin e Planit të Integritetit

Emri i institucionit: Bashkia _____

Adresa _____

Adresa e-mailit e Bashkisë: _____

Numri i telefonit i institucionit: _____

Emri dhe mbiemri i kreut të institucionit: _____

Emrat dhe mbiemrat e koordinatorit dhe anëtarët e grupit të punës për hartimin e planit të integritetit:

1. _____

2. _____

3. _____

4. _____

5. _____

6. _____

7. _____

Data e miratimit të planit të integritetit: ____/____/____

Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës për monitorimin e zbatimit të planit të integritetit _____

Informacion kontakti për personin përgjegjës për monitorimit e zbatimit të Planit të Integritetit Tel/Cel: _____; Email _____

5.2 Model urdhri për hartimin e një plani integriteti për Bashkinë _____

Urdhër Nr. _____, datë ____/____/_____

Nr. Prot. _____

“Për hartimi e Planit të Integritetit”

Bazuar në ligjin për Ligjin Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, “Strategjinë Sektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020” si dhe në lidhje me zbatimin e masave të veçanta të parashikuara në Planin e Veprimit 2018-2020 të miratuar me VKM nr. 241, datë 20.4.2018 për zbatimin e strategjisë ndër-sektoriale kundër korrupsionit, Kryetari i Bashkisë _____ (Emri i plotë i institucionit)

URDHËROJ:

Neni 1

Ngritjen e një grupi pune për hartimin e planit të integritetit për bashkinë _____.

Neni 2

Koordinator i grupit të punës përgjegjës për hartimin e planit integritetin në Bashkinë _____, emërohet _____ (emri, funksioni).

Anëtarë të grupit të punës përgjegjës për hartimin e planit të integritetit në _____ (emri i institucionit) caktohen:

1. _____, anëtar
2. _____, anëtar
3. _____, anëtar
4. _____, anëtar
5. _____, anëtar
6. _____, anëtar

Neni 3

3.1. Grupi i punës për hartimin e planit të integritetit, brenda 30 ditëve, harton një program pune për hartimin e planit të integritetit për bashkinë _____.

3.2 Grupi i punës për integritetin është i detyruar të hartojë një plan për integritetin e institucionit, në mbështetje të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe ia dorëzon këtë plan Kryetarit të Bashkisë _____, brenda 3 muajve nga data e miratimit të këtij urdhri.

Neni 4

Të gjithë punonjësit e Bashkisë _____ janë të detyruar t'i sigurojnë grupit të punës të gjithë ndihmën, mbështetjen dhe informacionet e nevojshme në procesin e hartimit të planit të integritetit për institucionin tonë.

Neni 5

Urdhri hyn në fuqi ditën e miratimit të tij nga Këshilli Bashkiak.

Kryetar i Bashkisë

(emër, mbiemër, firmë, vulë)

5.3 Modeli i njoftimit për hartimin e Planit të Integritetit

OBJEKTI: Njoftim për punonjësit për të ndërmarrë aktivitete, që kanë për qëllim zhvillimin e planit të integritetit për Bashkinë _____

Të nderuar kolegë,

Bashkia _____, në kuadër të angazhimeve për parandalimin e korrupsionit po përgatit Planin e Integritetit. Në këtë drejtim, ne ju informojmë se më datë ___/___/_____ është nxjerrë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë, Nr. ____, “Për hartimi e Planit të Integritetit” dhe është ngritur grupi i punës për hartimin e planit të integritetit për bashkinë tonë.

Sipas këtij urdhri, koordinatori i grupit të punës është caktuar _____ dhe për anëtarë te grupit të punës janë caktuar personat e mëposhtëm:

1. _____, anëtar
2. _____, anëtar
3. _____, anëtar
4. _____, anëtar
5. _____, anëtar
6. _____, anëtar

Në mënyrë që Grupi i Punës për Integritetin të mbledhë informacion gjithëpërfshirës dhe të dhëna të nevojshme për të hartuar planin e integriteti kërkoj nga të gjithë punonjësit e institucionit tonë mbështetjen, ndihmën dhe pjesëmarrjen aktive me informacione në këtë grup.

Theksoj që të gjithë punonjësit e bashkisë kanë detyrimin për të bashkëpunuar me Grupin e Punës për realizimin me sukses të procesit të zhvillimit të planit të integritetit.

Sinqerisht,

Kryetari i Bashkisë

5.4 Programi i punës i Grupit të Punës për planifikimin e integritetit

Bashkia _____

Kryetari i Bashkisë _____

Koordinator i Grupit të Punës për Integritetin _____

Anëtarët e Grupit të Punës për Planin e Integritetit:

Data e miratimit të programit të punës: ___/___/___

Fillimi i Planit të Integritetit: ___/___/___

Përfundimi i pritshëm: ___/___/___

Model programi punës

Faza 1: masa/aktiviteti	Personi përgjegjës	Afati i fundit
Vendimi për miratimin e Grupit të Punës për Integritetin (GPI)	Kryetari i Bashkisë	
Përgatitja e programit të punës së GPI	GPI	
Miratimi i programit të Punës për GPI	Kryetari i Bashkisë	
Informimi i punonjësve të bashkisë për aktivitetet e planifikuara në përgatitjen e planit të integritetit	Kryetari i Bashkisë	

Faza 2: masa/aktiviteti	Personi përgjegjës	Afati i fundit
Vlerësimi fillestar i integritetit	GPI	
Mbledhja e dokumentacionit të nevojshëm për zhvillimin e një plani integriteti	GPI	
Shqyrtimi dhe analizimi i dokumentacionit të mbledhur lidhur me vlerësimin e ekspozimit dhe rezistencën e institucionit ndaj rreziqeve	GPI	
Kryerja e një sondazhi me pyetësor anonim	GPI, punonjësit e Bashkisë	
Identifikimi, analizimi i risqeve dhe faktorët risqeve	GPI	
Vlerësimi i intensitetit të risqeve të identifikuara dhe renditja e risqeve	GPI	
Faza 3: masa/aktiviteti	Personi përgjegjës	Afati i fundit
Caktimi i masave për trajtimin e risqeve të identifikuara me qëllimin për të përmirësuar integritetin; dhe prioritizimin e masave të propozuara	GPI	
Përgatitja e regjistrit të riskut dhe planit të veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit.	GPI	
Faza 4: masa/aktiviteti	Personi përgjegjës	Afati i fundit
Përgatitja dhe dorëzimi i raportit për gjendjen e integritetit në Bashki.	GPI	
Shqyrtimi i planit të propozuar të integritetit.	Kryetari i Bashkisë	
Miratimi i planit të integritetit. Emërimi i personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit.	Këshillit Bashkiak/Kryetari i Bashkisë	

5.5.Regjistri i riskut

<p>Faktorët/Burimet e riskut të brendshëm</p> <p>Lidhen me aspekte të Ligjshmërisë (L)</p> <p>Burimet Njerëzore dhe institucionin (B)</p> <p>Informimi dhe Komunikimi (I)</p> <p>Procedurat dhe Proceset e Punës(P)</p>	<p>Masat ekzistuese / mekanizmat e kontrollit ekzistues në institucion</p>	<p>Analiza e riskut</p> <p>- i kontrolluar</p> <p>- pjesërisht i kontrolluar</p> <p>-i pakontrolluar</p>	<p>Vlerësimi i probabilitetit të shfaqjes së riskut</p>	<p>Vlerësimi i pasojave të ndodhjes së riskut</p>	<p>Intensitetit i riskut</p>
		<p><input type="checkbox"/> i kontrolluar</p>	<p><input type="checkbox"/> Risku nuk u paraqit në një periudhë të caktuar kohe (duhet të përcaktohet kjo periudhë) në të kaluarën ose shfaqet shumë rrallë, kështu që nuk ka gjasa që ajo të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen (1)</p>	<p><input type="checkbox"/> Pasojat për institucionin janë të parëndësishme (1)</p>	<p><input type="checkbox"/> i ulët</p>
		<p><input type="checkbox"/> pjesërisht i kontrolluar</p>	<p><input type="checkbox"/> Risku u shfaq në një numër rastesh gjatë një periudhe kohore (kjo periudhë duhet të ishte përcaktuar) në të kaluarën, kështu që probabiliteti i ndodhjes në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen është i moderuar(2)</p>	<p><input type="checkbox"/> Pasojat janë të rëndësishme nga institucioni (2)</p>	<p><input type="checkbox"/> i moderuar</p>
		<p><input type="checkbox"/> i pakontrolluar</p>	<p><input type="checkbox"/> Risku u shfaq shpesh gjatë një periudhe të caktuar kohore (kjo periudhë duhet të ishte përcaktuar) në të kaluarën dhe ka gjasë të mëdha që ai të ndodhë në të njëjtën periudhë kohore në të ardhmen (3)</p>	<p><input type="checkbox"/> Pasojat janë shumë të rëndësishme për institucionin (3)</p>	<p><input type="checkbox"/> i lartë</p>

5.6 Plani për menaxhimin e riskut të integritetit

Për çdo element të fushës së veprimtarisë së bashkisë është e nevojshme të caktohen dy rrezeqë minimale dhe të analizohen në mënyrën e mësipërme.

Risku	Masa për menaxhimin e riskut, ose për përmirësimin e integritetit të institucionit	Masat prioritare <ul style="list-style-type: none"> • Prioritet i lartë • Prioritet i moderuar • Prioritet i ulët 	Aktivitetet që duhet të ndërmerren për zbatimin e masës	Personi përgjegjës për zbatimin e masës dhe afati i fundit për zbatimin e aktiviteteve	Kostot e vlerësuara eventuale për zbatimin e masës
Është e nevojshme të identifikohet risku (p.sh pranimi i paligjshëm i dhuratave)	Propozon një grup pune bazuar në analizën e gjendjes së integritetit institucional dhe analizën e përgjigjeve nga pyetëtori	Grupi i punës përcakton prioritetin e secilës masë të propozuar bazuar në vlerësimin e intensitetit të riskut në tabelën e mëparshme ²¹	Grupi i punës përcakton cilat aktivitete janë të nevojshme për zbatimin e masës	Grupi i punës propozon një person (emri, mbiemri, funksioni), si dhe një afat kohor për zbatimin e secilës masë individuale	Grupi i punës vlerëson nëse do të kërkohen burime të caktuara financiare për të zbatuar disa nga masat

²¹Intensiteti i riskut të lartë përcakton prioritetin e lartë të masës, intensiteti i moderuar i riskut nënkupton një prioritet të moderuar të masës dhe një intensitet i ulët risku është një prioritet i ulët i masës.

5.7 Modeli i Vendimit për Miratimin dhe Zbatimin e Planit të Integritetit

Vendim i Këshillit Bashkiak, Nr. _____, datë ____/____/_____

Për miratimin dhe zbatimin e Planit të Integritetit për Bashkinë _____

Këshilli Bashkiak i Bashkisë _____ vendosi:

Neni 1

Miratimin e Planit të Integritetit për Bashkinë _____, bashkëlidhur këtij vendimi, i përgatitur nga grupi i punës të ngritur me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë, Nr. _____, datë ____/____/_____.

Neni 2

- (1) Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit caktohet z./zj. _____, me funksion _____.
- (2) Personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit ka për detyrë të monitorojë zbatimin e Planit të Integritetit, veçanërisht planin e veprimit për menaxhimin e riskut të integritetit dhe të bëjë sugjerimet e nevojshme për përmirësimin e tij.
- (3) Të gjithë punonjësit e Bashkisë _____ informojnë personin përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit në lidhje me gjendjen e integritetit të bashkisë, për veprime apo ngjarje që mund të ndodhin dhe mund të çojnë në cenimin e integritetit të bashkisë.
- (4) Punonjësit e bashkisë, me kërkesë të personit përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit, duhet të dorëzojnë të dhëna dhe informacione që janë të nevojshme për zbatimin e planit të integritetit dhe të cilat nuk bien në kundërshtim me rregulloret në fuqi.
- (5) Të paktën një herë në vit dhe më shpesh, nëse është e nevojshme, personi përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të planit të integritetit është i detyruar të paraqesë para Këshillit Bashkiak një raport mbi zbatimin e planit të integritetit.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Bashkëlidhur me Planin e Integritetit do të jenë:

- Raporti i grupit të punës për gjendjen e integritetit në bashki;
- Pyetësori për vlerësimin e integritetit të përdorur nga grupi i punës;
- Të tjera

SHTOJCA 1. PYETËSORI PËR BASHKITË

PYETËSOR I VETËVLERËSIMIT PËR PUNONJËSIT E BASHKISË

Bashkia _____ është duke punuar për hartimin e planit të integritetit në nivel vendor. Në kuadër të këtij procesi, grupi i punës për hartimin e Planit të Integritetit në bashkinë tonë po zhvillon një sondazh me punonjësit e bashkisë për perceptimet përvojat e tyre në lidhje me çështjet e etikës dhe integritetit në bashki. Të dhënat e këtij anketimi do t'i shërbejnë procesit të vlerësimit dhe analizimit të risqeve të integritetit në bashki, me qëllim parandalimin e korrupsionit dhe forcimin e integritetit në institucion.

Grupi i Punës garanton anonimatën dhe konfidencialitetin e të dhënave si dhe përdorimin e tyre vetëm për qëllime studimore.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin tuaj!

I. TË DHËNA DEMOGRAFIKE:

1. Gjinia:

- Mashkull Femër

2. Cilës grup moshe i përkisni:

- Deri në 25 vjeç 26-35 vjeç 36 -45 vjeç 46-55 vjeç Mbi 56 vjeç

3. Sa vite përvojë pune keni në bashki?

- Më pak se 5 vjet 5-10 vjet 11-20 vjet 21-30 vjet Mbi 30 vjet

II. DETYRAT, PËRGJEGJËSITË DHE PROCEDURAT E PUNËS NË BASHKI

4. Deri në çfarë mase jeni njohur me detyrat e funksionit tuaj, sipas pozicionit organik që keni në bashki/përshkrimin e vendit të punës? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1 - aspak dhe 5 – plotësisht.

1 <input type="checkbox"/> Aspak	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Plotësisht
----------------------------------	----------------------------	----------------------------	----------------------------	---------------------------------------

5. A janë përshkruar dhe dokumentuar me hollësi procedurat e punës që ju duhet të ndiqni?

- Po Jo Nuk e di

6. A jeni dakord me pohimin se procedurat e punës garantojnë një ndarje të përshtatshme të detyrave në njësinë/drejtorinë tuaj, në mënyrë që i njëjti person të mos ketë mbivendosje të përgjegjësive? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1 – aspak dakord dhe 5 – plotësisht dakord.

1 <input type="checkbox"/> Aspak dakord	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Plotësisht dakord
---	----------------------------	----------------------------	----------------------------	--

7. Në praktikë, a ju janë ngarkuar detyra shtesë përtej përshkrimit të detyrave sipas pozicionit tuaj të punës?

Po Jo

8. Nëse përgjigja e pyetjes së mëparshme është “Po”, a këshilloheni me eprorët tuaj para se të merrni vendime për këto detyra shtesë?

Po Jo

9. A janë eprorët tuaj lehtësisht të disponueshëm për t’u konsultuar me ju?

Po Jo Tjetër _____

10. Nëse kryeni konsultime të përbashkëta me eprorin, sa shpesh diskutoni për çështjen e forcimit të integritetit personal dhe institucional?

Asnjëherë Rrallë (1-2 herë në vit) Me raste (\leq 1 herë në muaj)
 Shpesh ($>$ 1 herë në muaj)

11. Mesatarisht, sa shpesh i raportoni eprorëve tuaj për punën tuaj?

$<$ 1 herë në muaj rreth 1 herë në muaj $>$ 1 herë në muaj

12. A kryhen institucioni juaj vlerësime të rregullta të punonjësve në bashkinë tuaj?

Po Jo Nuk e di

Nëse po, lutem specifikoni sa herë kryhen vlerësimet brenda një viti _____

13. Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 sistemin e vlerësimit të performancës në punë, sipas kriterëve më poshtë:

a) Qartësia

1 <input type="checkbox"/> Aspak i qartë	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Shumë i qartë
--	----------------------------	----------------------------	----------------------------	--

b) Transparenca

1 <input type="checkbox"/> Aspak transparent	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Shume Transparent
--	----------------------------	----------------------------	----------------------------	--

c) Objektiviteti

1 <input type="checkbox"/> Aspak objektiv	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Shumë objektiv
---	----------------------------	----------------------------	----------------------------	---

d) Mjaftueshmëria e kohës

1 <input type="checkbox"/> Aspak e mjaftueshme	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Shumë e mjaftueshme
--	----------------------------	----------------------------	----------------------------	--

14. Nëse sistemi i vlerësimit ka mangësi, cilat mund të jenë arsyet? (Mund të jepni më shumë se një përgjigje)

- Vlerësimi është proces formal
- Sistemi aktual i vlerësimit krijon hapësira për subjektivitet
- Tjetër _____

15. A ka bashkia juaj një plan për kualifikimin profesional të punonjësve?

- Po Jo Nuk e di

16. Sa të informuar jeni mbi këtë plan? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1 - aspak të informuar dhe 5 – plotësisht të informuar.

1 <input type="checkbox"/> Aspak të informuar	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Plotësisht të informuar
---	----------------------------	----------------------------	----------------------------	--

III. MENAXHIMI I ETIKËS DHE INTEGRITETIT NË BASHKI

17. Gjatë punës tuaj, a jeni hasur me situata ku iu është dashur të keqpërdornit pozicionin tuaj (ose a keni dëgjuar se disa nga kolegët tuaj ishin në një situatë të tillë)?

- Personalisht nuk kam qenë në situata të tilla dhe as nuk njoh njeri që mund të ketë hasur të tilla situata.
- Personalisht nuk kam qenë në situata të tilla, por jam në dijeni të rasteve të keqpërdorimit të pozicionit në bashki.
- Të tjerë më kanë këshilluar që të veprojmë në kundërshtim me rregulloret e brendshme.
- Po, ka ndodhur që më duhet të veproja në kundërshtim me rregulloret e brendshme.
- Nuk jam në dijeni që kolegët e mi kanë keqpërdorur detyrën.

18. A keni dëgjuar për ndonjë përpjekje nga personat brenda ose jashtë institucionit tuaj për të ndikuar në vendimet profesionale të kolegëve tuaj?

- Po Jo

19. Nëse përgjigjja për pyetjen më sipër është po, sa shpesh jeni gjendur në situata të tilla? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1 - rrallëherë dhe 5 – shumë shpesh.

1 <input type="checkbox"/> Rrallëherë	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Shumë shpesh
---------------------------------------	----------------------------	----------------------------	----------------------------	---

20. A jeni në dijeni të rasteve të kolegëve tuaj që kanë kryer një sjellje jo-etike dhe jo-profesionale ndaj kolegëve të tjerë?

- Po Jo Nuk e di

21. Nëse përgjigjja për pyetjen e mësipërme është “po”, si keni vepruar kur jeni vënë në dijeni?

- E kam raportuar sjelljen tek eprori
- E kam raportuar sjelljen te struktura(t) përkatëse
- E kam takuar kolegun dhe i kam kërkuar të ndreqë gabimin
- Nuk kam reaguar
- Tjetër _____

22. Gjatë marrëdhënieve të punës a ka pasur situata ku mendoni se jeni trajtuar nga eprori juaj në mënyrë të diferencuar?

- Po Jo

23. Gjatë marrëdhënieve të punës a ka pasur situata ku mendoni se ndonjë nga kolegët tuaj është trajtuar në një mënyrë të diferencuar?

- Po Jo

24. Nëse keni kryer apo dëgjuar ndonjëherë për aktivitete/veprime që janë objekt i parregullsive apo që mund të konsiderohen sjellje jo-etike dhe jo-profesionale, në bashkinë tuaj, a mund të jepni tre shembuj të këtyre:

- Shembulli 1:

- Shembulli 2:

- Shembulli 3:

IV. RREGULLORE DHE UDHËZIME PËR SJELLJEN JO-ETIKE DHE INTEGRITETIN NË BASHKI

25. Në dijeninë tuaj, në bashkinë tuaj a ka ndonjë rregullore të veçantë / procedura të miratuara që trajtojnë aktivitetet e natyrës korruptive apo sjelljet jo-etike?

- Po
- Jo
- Nuk e di nëse rregulloret /rregullat e brendshme ekzistojnë në bashki

26. Nëse përgjigja e pyetjes së mëparshme është “Po”, lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 sa jeni të njohur me përmbajtjen e rregullores/ve?

1 <input type="checkbox"/> Aspak	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Plotësisht
----------------------------------	----------------------------	----------------------------	----------------------------	---------------------------------------

27. Nëse përgjigja për pyetjen nr. “25” është “Po”, lutem vlerësoni sa të qarta dhe lehtësisht të kuptueshme janë këto rregulla nga punonjësit e bashkisë? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1 - Aspak të qarta dhe 5 – Shumë të qarta.

1 <input type="checkbox"/> Aspak të qarta	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Shumë të qarta
---	----------------------------	----------------------------	----------------------------	---

28. Në dijeninë tuaj, në rast se një punonjës i bashkisë sinjalizon një veprim apo praktikë të dyshuar të korrupsionit në bashki, a ka rregulla për mbrojtjen e sinjalizueseve dha a zbatohen ato në praktikë?

- Po, ka rregulla dhe zbatohen në praktikë
- Po, ka rregulla, por nuk zbatohen në praktikë
- Jo, nuk ka rregulla të tilla
- Nuk jam në dijeni nëse ka rregulla të tilla

29. Nëse ekzistojnë rregulla të tilla, a jeni trajnuar për këto rregulla?

- Po
- Jo

30. Nëse përgjigja e për pyetjen nr. “29” është “Jo”, cila është, sipas mendimit tuaj, arsyeja për këtë?

- Në bashkinë në të cilin punoj, nuk janë regjistruar raste të mashtrimit, vjedhjes ose veprimeve të tjera që përbëjnë shkelje të integritetit.
- Në institucionin ku unë punoj ka raste të tilla, por ato injorohen ose zbuten.
- Nuk e di

31. A ka rregullore/procedura në institucionin tuaj lidhur me pranimin dhe administrimin e dhuratave?

- Po Jo Nuk e di

32. Nëse përgjigja e pyetjes së mëparshme është “Po”, lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 sa jeni të njohur me përmbajtjen e rregullores/ve?

1 <input type="checkbox"/> Aspak	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Plotësisht
----------------------------------	----------------------------	----------------------------	----------------------------	---------------------------------------

33. Nëse hasni një situatë në konflikt interesi a e dini se kujt duhet t'i raportoni në bashkinë tuaj?

- Po
 Njësia ku duhet të raportoj është: _____
 Jo

34. Nëse përgjigja për pyetjen më sipër është “Po”, a keni dijeni nëse këto raste janë regjistruar zyrtarisht brenda bashkisë në të cilën punoni?

- Po, ato regjistrohen
 Jo, nuk janë të regjistruara
 Nuk e di

35. A ka një strukturë/ person në bashkinë tuaj, i cili ka për detyrë të monitorojë nëse punonjësit janë në konflikt interesi në kryerjen e një aktiviteti?

- Po Jo Nuk e di

36. A janë realizuar trajnime/konsultime me ju për çështjet e konfliktit të interesit nga kjo strukturë/person përgjegjës për konfliktin e interesit?

- Po Jo

37. Sa mirë mendoni se e njihni ligjin për konfliktin e interesit dhe detyrimet që vijnë nga ky ligj?

1 <input type="checkbox"/> Aspak	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Plotësisht
----------------------------------	----------------------------	----------------------------	----------------------------	---------------------------------------

38. A ka rregulla/procedura në institucionin tuaj që rregullojnë punësimin e dytë nga punonjësit e administratës së bashkisë?

- Po Jo Nuk e di

39. Deri në çfarë mase i njihni këto rregullore? Ju lutem vlerësoni në një shkallë nga 1 në 5 ku 1 - aspak dhe 5 – plotësisht.

1 <input type="checkbox"/> Aspak	2 <input type="checkbox"/>	3 <input type="checkbox"/>	4 <input type="checkbox"/>	5 <input type="checkbox"/> Plotësisht
----------------------------------	----------------------------	----------------------------	----------------------------	---------------------------------------

40. A mendoni që këto rregullore zbatohen?

- Rrallëherë Me raste Shpesh Shumë shpesh Nuk e di

41. A ka procedura të qarta në bashkinë ku punoni që të garantojnë ngritjen në detyrë mbi baza meritokracie?

- Po Jo Nuk e di

42. Nëse përgjigjja për pyetjen 41 është “po”, a mendoni se zbatohen këto procedura?

- Rrallëherë Me raste Shpesh Shumë shpesh Nuk e di

43. A ka ndonjë udhëzim të shkruar në bashkinë tuaj lidhur me mënyrën e komunikimit brenda përbrenda bashkisë (komunikimit me shkrim, elektronik, ose verbal)?

- Po Jo Nuk e di

44. Deri në çfarë mase zbatohen rregullat në lidhje me komunikimin?

- Rrallëherë Me raste Shpesh Shumë shpesh Nuk e di

45. A ekzistojnë rregulla në bashkinë tuaj në lidhje me ruajtjen e informacionit konfidencial/të klasifikuar?

- Po Jo Nuk e di

46. Nëse përgjigja e pyetjes nr. “45” është “Po”, sa zbatohen këto rregulla në praktikë?

- Rrallëherë Me raste Shpesh Shumë shpesh Nuk e di

47. A jeni trajnuar mbi këto rregulla?

- Po Jo

48. Si e informoni publikun për aktivitetet e bashkisë tuaj (mund të zgjidhni disa përgjigje):

- Nëpërmjet njësisë përgjegjëse: Koordinatori për të drejtën e informimit
- Nëpërmjet informacionit që vendoset në faqen e internetit
- Nëpërmjet konferencave për shtyp
- Përmes konsultimeve publike
- Me e-mail.
- Tjetër - specifikoni _____

49. A ka një strukturë në bashki që është përgjegjëse për monitorimin e rasteve të shkeljeve të normave etike?

- Po
- Nëse po, specifikoni cila është kjo strukturë _____
- Jo
- Nuk e di

50. A mendoni se i njihni mirë procedurat për trajtimin e shkeljeve të etikës si dhe masat disiplinore në rast të shkeljeve?

- I kam lexuar, jam trajnuar dhe i kuptoj
- I kam lexuar por nuk jam trajnuar, i kuptoj deri diku
- I kam lexuar, por nuk i kuptoj
- Kam nevojë për sqarime të mëtejshme
- Nuk i kuptoj mirë
- Nuk jam njohur ndonjëherë me to

51. Nëse jeni i/e mirëinformuar për trajtimin e shkeljeve të etikës, ju lutem rrethoni opsionin që përputhet me mendimin tuaj: a mendoni se kjo procedurë është efikase dhe se caktimi i masave disiplinore kryhet në përputhje me ligjet që rregullojnë marrëdhëniet e punës dhe/ose statusin e zyrtarëve?

- Po, procedura është efikase dhe masat disiplinore kryhen në përputhje me legjislacionin përkatës
- Procedura është korrekte, por masat disiplinore nuk jepen gjithmonë sipas legjislacionin përkatës
- Procedura nuk është efikase dhe masat disiplinore nuk jepen gjithmonë sipas legjislacionin përkatës

52. Nëse përgjigjja për pyetjen nr. “51” është alternativa e fundit, a mendoni se kjo procedurë ka nevojë që të riorganizohet/ndryshohet ?

- Po, ju lutem specifikoni arsyen: _____
- Jo
- Nuk e di

53. Deri në çfarë mase jeni dakord me pohimet e mëposhtme në një shkallë nga 1 në 5 ku 1- shumë dakord dhe 5 –aspak dakord:

POHIMET	Shumë dakord (1)	Dakord (2)	Neutral (3)	Pjesërisht dakord (4)	Aspak dakord (5)
Kryerja e ndonjë veprimtarie të vogël private gjatë orarit të punës është e tolerueshme.					
Ish-zyrtarë të bashkisë nuk duhet të përfaqësojnë brenda një periudhë 2-vjecare persona, biznese apo organizata që janë në konflikt apo marrëdhënie tregtare/interesi me bashkinë, për detyra që ish-zyrtari ka kryer më përpara në bashki.					
Konflikti midis interesit privat dhe funksionit të punonjësve duhet patjetër të raportohet.					
Është e nevojshme që në kryerjen dhe qartësimin e detyrave të punës të zhvillohen konsultime të përbashkëta me eprorët dhe kolegët.					
Bashkia duhet të ketë rregulla të qarta për marrjen dhe administrimin e dhuratave nga palë e treta.					
Mendoj që gjatë vlerësimit eprori duhet të konsiderojë më shumë volumin e punës se sa cilësinë e punës së kryer.					

BIBLIOGRAFIA

Ligje dhe urdhra

- Ligji Nr. 8778/2001 “Për Ratifikimin e Konventës Penale për Korrupsionin” dhe Ligji Nr. 9245/2004, ratifikimi i protokollit shtesë.
- Ligji Nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurisë, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”.
- Ligji Nr. 9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”.
- Ligji Nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.
- Ligj nr. 9492/2006 “Për Ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Korrupsionit”.
- Ligji Nr. 9508/2006 “Për bashkëpunimin e publikut në luftën kundër korrupsionit”.
- Ligji Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik” i ndryshuar si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Ligji Nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- Ligji Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- Ligji Nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.
- Ligji Nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr. 60/2016 “Për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve”.
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Ligji Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- Urdhri nr. 41 datë 30.03.2015 i kryetarit të Kontrollit të Lartë të Shtetit “Për miratimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut në Kontrollin e Lartë të Shtetit”.

Burime të tjera

- Monkova. M. (2015) “Udhëzues për planifikimin e integritetit dhe menaxhimin e integriteti, Kosovë: UNDP.
- Monkova. M. (2018) “Guide to Corruption-Free Local Government”: UNDP.

Selinsek, Liljana (2015) "Corruption Risk Assessment in Public Institutions in South East Europe Comparative Study and Methodology", Regional Corporation Council, f. 18 (e disponueshme: http://rai-see.org/wp-content/uploads/2015/10/CRA_in_public_ins_in_SEE-WEB_final.pdf).

Internet

[http://corruptionprevention.gov.hu/download/8/f2/90000/Integrity%20and%20integrity%20management%20\(Ka talin%20Pallai\).pdf](http://corruptionprevention.gov.hu/download/8/f2/90000/Integrity%20and%20integrity%20management%20(Ka%20talin%20Pallai).pdf).

http://integrityobservers.eu/UserDocs/Images/Dutch_Approach.pdf

http://parlament.al/web/Keshilli_Kombetar_i_integrimet_Europian_20627_1.php

<http://www.ferma.eu/app/uploads/2011/10/a-structured-approach-to-erm.pdf>

<http://www.ferma.eu/app/uploads/2011/11/a-risk-management-standard-englishversion.pdf>

<https://www.unglobalcompact.org/resources/411>